FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 72	**2002**	**Nëntor**

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8953 datë 17.10.2002	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për ripranimin e personave"……	2003
Ligj nr. 8954 datë 17.10.2002	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së grantit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë për asistencë në financimin e shërbimeve të konsulencës, për rehabilitimin dhe përmirësimin e sistemeve ekzistuese të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza në Burrel, në qarkun e Dibrës"……	2008
Ligj nr. 8955 datë 17.10.2002	Për ratifikimin e "Kontratës financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin e rehabilitimit të infrastrukturës së Portit të Durrësit"…….	2016
Vendim i KM nr. 532, datë 31.10.2002	Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës në komunë dhe /ose	2030

Vendim i KM nr. 535, datë 31.10.2002	bashki…… … Për miratimin e buxhetit të Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja (ANIH), për vitin 2002……	2034
Vendim i KM nr. 537, datë 24.10.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme, që preket nga ndërtimi i superstradës Vorë-Durrës, Seksioni i dytë Sukth-Durrës (kryqëzimi i Urës së Dajlanit)…… ……	2035
Vendim i KM nr. 538, datë 24.10.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme, që preket nga ndërtimi i superstradës Vorë-Durrës, seksioni i parë Vorë-Sukth (Inter-Change Sukth)	2036

L I G J
Nr. 8953, datë 17.10.2002

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË RUMANISË PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për ripranimin e personave", nënshkruar në Bukuresht më 7.6.2002.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3543, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË RUMANISË PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Rumanisë, të referuara më poshtë si "Palët Kontraktuese":

Duke dëshiruar të zhvillojnë bashkëpunimin ndërmjet shteteve të tyre respektive, me qëllim për të siguruar një zbatim më të mirë të dispozitave për lëvizjen e personave;

Duke qenë të ndërgjegjshëm për nevojën për të luftuar migracionin e paligjshëm dhe me qëllim për të lehtësuar, mbi një bazë të ndërsjellë, ripranimin e personave që hyjnë dhe qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në territorin e shtetit të secilës Palë Kontraktuese;

Në përputhje me marrëveshjet e traktatet ndërkombëtare;

Ranë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termat e listuara më poshtë kanë kuptimet si vijon:

1. "I huaj" nënkupton një person i cili nuk ka shtetësinë e shtetit të ndonjërës nga Palët Kontraktuese.

2. "Vizë" nënkupton një leje të vlefshme të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të Palës Kontraktuese, që i jep të drejtën një personi të hyjë dhe qëndrojë në territorin e shtetit të tij, pa ndërprerje, për një periudhë të përcaktuar kohe, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të këtij shteti.

3. "Leje qëndrimi" nënkupton një leje të vlefshme të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të Palës Kontraktuese, që i jep të drejtë personit që e mban atë të hyjë në mënyrë të përsëritur dhe të qëndrojë në territorin e këtij shteti. Leja e qëndrimit nuk paraqet një vizë dhe nuk mund të merret si një leje qëndrimi e përkohshme që i është dhënë një personi për të lejuar qëndrimin e tij në

territorin e shtetit të një Pale Kontraktuese në lidhje me ekzaminimin e një aplikimi azili ose gjatë një procedure dëbimi.

Neni 2
Ripranimi i shtetasve të vet

1. Çdo Palë Kontraktuese do të ripranojë, në bazë të kërkesës nga Pala tjetër Kontraktuese dhe pa formalitete të veçanta, personin i cili nuk përmbushte ose që nuk përmbush me kërkesat ligjore qëndrimin e tij saj në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese Kërkuese, me kusht që të jetë provuar ose të jetë bazueshmërisht e supozuar që ky person ka shtetësinë e Palës Kontraktuese së Kërkuar.

2. E njëjta procedurë do të aplikohet gjithashtu ndaj personit i cili ka humbur shtetësinë e Palës Kontraktuese së Kërkuar pas hyrjes së tij/saj në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese, përveç kur personi është garantuar që do të marrë shtetësinë e shtetit të Palës Kontraktuese Kërkuese.

3. Në bazë të aplikimit nga Pala Kontraktuese Kërkuese, Pala Kontraktuese e Kërkuar, pa vonesë, do t'i lëshojë personit, subjekt të ripranimit sipas dispozitave të paragrafit 1 dhe 2, dokumentet e nevojshme të udhëtimit për kthimin e tij/saj ose, sipas rastit, do të njohë dokumentin e udhëtimit të standardit të BE-së të lëshuar nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese Kërkuese (sipas modelit të paraqitur bashkëlidhur).

4. Nëse hetime të mëtejshme rezultojnë në të provuarit se personi i ripranuar nuk ishte një shtetas i shtetit të Palës Kontraktuese së Kërkuar në momentin e nisjes së tij/saj nga territori i shtetit të Palës Kontraktuese Kërkuese dhe ai/ajo nuk përmbush kërkesat e parashikuara nga paragrafi 1 i këtij neni ose nga neni 4, Pala Kontraktuese Kërkuese do të marrë detyrimin të ripranojë menjëherë personin respektiv në bazë të procedurave të ripranimit.

5. Kjo procedurë nuk do të aplikohet nëse kërkesa e ripranimit bazohet në faktin që Pala Kontraktuese e Kërkuar ka hequr shtetësinë e personit respektiv pas hyrjes së tij/saj në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese, përveç kur personit i është garantuar dhënia e shtetësisë nga autoritetet kompetente të shtetit të Palës Kontraktuese Kërkuese.

Neni 3
Të provuarit ose supozimi i shtetësisë

1. Shtetësia konsiderohet e provuar nga një pasaportë e vlefshme kombëtare ose nga një dokument i vlefshëm identiteti të lëshuara për shtetasin e vet nga autoritetet kompetente të shtetit të Palës Kontraktuese së Kërkuar, nëse këto dokumente mund t'i atribuohen qartë mbajtësit të tyre.

2. Shtetësia mund të supozohet vlefshmërisht e bazuar mbi evidencën prima facie, si vijon:

a) çdo dokument të listuar sipas paragrafit 1, edhe nëse ka skaduar vlefshmëria e tij;

b) një dëshmi me shkrim e personit konkret;

c) një deklaratë me shkrim nga një person i tretë;

d) evidencë tjetër, e cila, në rastet konkrete, njihet nga Pala Kontraktuese e Kërkuar.

3. Nëse prova ose prima facie e referuar sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni nuk janë të mjaftueshme për të provuar ose supozuar vlefshmërisht shtetësinë, misioni diplomatik ose zyra konsullore kompetente e Palës Kontraktuese së Kërkuar, pa vonesë, do të intervistojë personin konkret, me qëllim që të përcaktojë shtetësinë e tij/saj.

Neni 4
Ripranimi i të huajve

1. Çdo Palë Kontraktuese, në bazë të kërkesës së Palës tjetër Konktraktuese, do të ripranojë një të huaj, i cili ka hyrë në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese Kërkuese direkt nga territori i shtetit të Palës Kontraktuese së Kërkuar dhe që nuk përmbush kushtet ligjore për hyrje dhe qëndrim në këtë territor.

2. Çdo Palë Kontraktuese, në bazë të kërkesës së Palës tjetër Kontraktuese, do të ripranojë një të huaj, i cili qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese Kërkuese dhe që mban një leje të vlefshme qëndrimi, një vizë të vlefshme ose një dokument tjetër të vlefshëm të lëshuar nga autoritete kompetente të shtetit të Palës Kontraktuese së Kërkuar, që i japin të drejtë

personit respektiv të hyjë dhe të qëndrojë në territorin e këtij shteti.

Neni 5
Përjashtimet nga detyrimi për të ripranuar të huajt

1. Detyrimi i ripranimit i parashikuar sipas nenit 4 nuk do të ekzistojë në rastin e të huajve, të cilët në kohën e hyrjes në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese Kërkuese mbanin një leje të vlefshme qëndrimi, një vizë të vlefshme ose një dokument tjetër të vlefshëm, të lëshuar nga autoritetet e kësaj Pale Kontraktuese, ose i kanë marrë ato pas hyrjes në këtë territor respektiv.

2. Në rast se të dyja Palët Kontraktuese i kanë lëshuar një të huaji, subjekt i një kërkese për ripranim një vizë hyrjeje ose një leje qendrimi, Pala Kontraktuese, vlefshmëria e vizës së hyrjes ose e lejes së qëndrimit të së cilës ka skaduar më vonë, do të ripranojë këtë të huaj.

Neni 6
Tranziti

1. Në bazë të kërkesës së bazuar nga njëra Palë Kontraktuese, Pala tjetër Kontraktuese do të autorizojë të huajt, subjekt të një procedure ripranimi drejt një shteti të tretë, të hyjnë dhe të kalojnë tranzit përmes territorit të shtetit të saj. Pala Kontraktuese e Kërkuar mund të vendosë kushte për lëshimin e një autorizimi të tillë, duke kërkuar praninë e një përfaqësuesi të autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese Kërkuese, me qëllim që të sigurojë eskortë gjatë tranzitit në territorin e shtetit të saj dhe, gjithashtu, duke kërkuar që, në të njëjtën kohë, me bërjen e kërkesës për një tranzitim të tillë, të jepen garanci për mundësinë e personit respektiv për të vazhduar udhëtimin e tij/saj dhe për të hyrë në territorin e shtetit të destinacionit.

2. Pala Kontraktuese e Kërkuar do të japë vizë tranziti falas për personin e eskortuar dhe eskortën, në përputhje me legjislacionin që zbatohet.

3. Nëse i huaji, subjekt i procedurës së ripranimit nuk lejohet të hyjë në territorin e një shteti të tretë ose nëse, pa marrë parasysh arsyen, vazhdimi i udhëtimit nuk është më i mundur, Pala Kontraktuese Kërkuese do të marrë gjithë përgjegjësinë për marrjen përsipër të këtij të huaji dhe për rikthimin, pa vonesë, të tij/saj në territorin e shtetit të saj.

4. Nëse ka tregues të qartë se personi, subjekt të një kërkese tranziti mund të jetë në rrezik në shtetin e destinacionit nga qenia i ekspozuar ndaj dënimit me vdekje ose ndaj vuajtjes së torturave, trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor, të egër ose degradues, si dhe nëse garancitë e parashikuara sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk pëlqehen, Pala Kontraktuese i rezervon të drejtën vetes që të refuzojë një kërkesë të tillë.

Neni 7
Afatet kohore

1. Çdo Palë Kontraktuese, pa vonesë, do të japë një përgjigje me shkrim për kërkesën e ripranimit të bërë ndaj saj dhe, në çdo rast, jo më vonë se njëzet ditë pune nga data kur është marrë kjo kërkesë. Kërkesa e ripranimit mund t'i drejtohet autoriteteve kompetente të Palës Kontraktuese së Kërkuar me postë, dorazi ose me çdo mjet komunikimi, duke përfshirë depozitimin e saj në misionin diplomatik ose zyrën konsullore kompetente të Palës Kontraktuese së Kërkuar. Çdo refuzim i një kërkese të tillë do të arsyetohet.

2. Pala Kontraktuese e Kërkuar do të marrë në dorëzim personin, subjekt të procedurës së ripranimit, menjëherë pas komunikimit të miratimit të kërkesës së ripranimit dhe, në çdo rast, jo më vonë se një muaj pas datës së miratimit. Në bazë të njoftimit nga Pala Kontraktuese e interesuar, ky afat kohor mund të zgjatet me kohën e duhur për të sqaruar ndonjë pengesë ligjore ose praktike që mund të ndodhë.

Neni 8
Periudha e detyrimit për të ripranuar

Kërkesa për ripranimin e personit sipas nenit 4 do t'i bëhet autoriteteve kompetente të Palës

Kontraktuese së Kërkuar, më e shumta brenda dymbëdhjetë muajve nga data kur është njohur zyrtarisht hyrja ose qëndrimi i paligjshëm i këtij personi në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese Kërkuese.

Neni 9
Shkëmbimi dhe mbrojtja e informacionit

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, informacioni i dhënë për raste individuale Palës tjetër Kontraktuese do të ketë lidhje vetëm me:

a) të dhënat personale të personit, subjekt të kërkesës së ripranimit dhe, kur nevojitet, të pjesëtarëve të familjes së tij/saj (mbiemrin, emrat, ndonjë emër të mëparshëm, alias-et, pseudonimet, datën dhe vendin e lindjes, seksin, shtetësinë aktuale dhe të mëparshme);

b) pasaportën, kartën e identitetit ose dokumente të tjera udhëtimi (numrin, datën e lëshimit, autoritetin që e ka lëshuar, vendin e lëshimit, periudhën e vlefshmërisë, territorin e vlefshmërisë);

c) të dhëna të tjera të nevojshme për të identifikuar personin;

d) lejen e qëndrimit dhe/ose vizën e lëshuar nga autoritetet e shteteve të Palëve Kontraktuese ose të shteteve të treta, itineraret, vendet e qëndrimit, biletat e udhëtimit ose rregullime të tjera të mundshme udhëtimi;

e) ndonjë informacion tjetër që provon se personi ka qëndruar në territorin e shtetit të njërës nga Palët Kontraktuese;

f) nevojën për kujdesin e veçantë për të moshuarit dhe personat e sëmurë, nëse nevojitet.

2. Informacioni i siguruar sipas paragrafit 1 do të transmetohet në përputhje me dispozitat e legjislacionit që zbatohet në shtetin e Palës Kontraktuese që i jep ato.

3. Të dhënat personale mund t'i transmetohen vetëm autoriteteve kompetente të secilës Palë Kontraktuese. Autoritetet kompetente të secilës Palë Kontraktuese do të sigurojnë mbrojtjen e të gjithë informacionit të marrë sipas kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin që zbatohet nga shtetet e tyre respektive.

4. Secila Palë Kontraktuese merr përsipër:

a) të përdorë çdo informacion të marrë sipas kësaj Marrëveshjeje, vetëm për qëllimin për të cilin është marrë;

b) të ruajë konfidencialitetin e informacionit të dhënë Palës Kontraktuese së Kërkuar dhe të mos t'ia transmetojë këtë informacion një Pale të tretë, përveç kur ky transmetim autorizohet nga Pala Kontraktuese Kërkuese;

c) të mbrojë këtë informacion kundër çdo humbjeje aksidentale, hyrjeje të paautorizuar, ndryshimi ose publikimi;

d) të shkatërrojë këtë informacion në përputhje me çdo kusht të vënë nga Pala Kontraktuese Kërkuese dhe, nëse nuk ka kushte të tilla, sapo informacioni nuk nevojitet më, për qëllimin për të cilin është siguruar;

e) personave, të cilët janë objekt i shkëmbimit të informacionit në aplikim të kësaj Marrëveshjeje, t'u jepen të dhënat personale konform legjislacionit kombëtar përkatës, si dhe të drejtën për t'u njohur me mënyrën e përdorimit të këtyre të dhënave e, në rast të kundërt, të korrigjojë gabimet e mundshme.

Neni 10
Shpenzimet

1. Pala Kontraktuese Kërkuese do të përballojë të gjitha shpenzimet për transportin e personit, subjekt të ripranimit, në bazë të Marrëveshjes në fjalë, duke përfshirë eskortën, deri në kufijtë e Palës Kontraktuese së Kërkuar.

2. E njëjta Palë Kontraktuese do të përballojë, gjithashtu, të gjitha shpenzimet e transportit që rrjedhin nga përmbushja e detyrimit për të ripranuar personat sipas nenit 2 paragrafi 4.

3. Në rastin e pranimit në tranzit të personave, subjekte të procedurës së ripranimit me një shtet të tretë, Pala Kontraktuese Kërkuese do të përballojë të gjitha shpenzimet e lidhura me

transportin e këtyre personave dhe të eskortës për në shtetin e destinacionit dhe, duke mos marrë parasysh arsyen, nëse vazhdimi i udhëtimit nuk është më i mundur, ajo do të përballojë gjithashtu shpenzimet për kthimin e këtyre pesonave në shtetin e saj.

Neni 11
Transportimi i të mirave personale të fituara në mënyrë të ligjshme

1. Pala Kontraktuese Kërkuese do të lejojë personin, subjekt të procedurës së ripranimit, për të transportuar për në shtetin e destinacionit të tij/saj, të mirat e tij/saj, të fituara në përputhje me legjislacionin që zbatohet.

2. Pala Kontraktuese Kërkuese nuk do të ketë detyrim për sa më sipër për të mbuluar shpenzimet për transportin e këtyre të mirave.

Neni 12
Dispozita për zbatimin

1. Brenda 10 ditësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, për autoritetet kompetente të përcaktuara për të zbatuar atë, si dhe për adresat e tyre ose informacionin tjetër të nevojshëm për të lehtësuar komunikimin. Palët Kontraktuese, gjithashtu, do të informojnë njëra-tjetrën rreth ndryshimeve të ndodhura në lidhje me këto autoritete.

2. Përfaqësuesit e autoriteteve kompetente do të takohen në çdo kohë që nevojitet për të analizuar modalitetet e aplikimit të kësaj Marrëveshjeje dhe do të bien dakord për rregullimet praktike për zbatimin e saj.

3. Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente do të nënshkruajnë një protokoll me të cilin do të bien dakord dhe mbi zgjidhje të tjera në lidhje me zbatimin e saj, të tilla si:

- detaje, dokumente që japin evidencën dhe masat e nevojshme për të bërë transferimin dhe tranzitin;
- përcaktimin e pikave të kalimit kufitar dhe vendosjen e datave për ripranim;
- kushtet e transportit në tranzit për një shtetas të një vendi të tretë nën eskortë nga autoritetet kompetente;
- pjesë e provave ose të provave prima facie, në bazë të së cilës mund të provohet ose të supozohet si e vërtetë që i huaji ka hyrë në territorin e një shteti të një Pale Kontraktuese direkt nga territori i shtetit të Palës tjetër Kontraktuese;
- formatin dhe përmbajtjen e kërkesës së ripranimit, formatin e fushës individuale me të dhëna personale, regjistrime të personave, subjekte të procedurave të ripranimit, gjuhën e punës, etj.

Neni 13
Marrëdhënia me instrumentet e tjera ligjorë ndërkombëtarë

1. Asnjë gjë në këtë Marrëveshje nuk do të paragjykojë, në çfarëdolloj mënyre, të drejtat e fituara dhe detyrimet e marra nga ndonjëri prej shteteve të Palës Kontraktuese, që rrjedhin nga instrumente të tjerë ligjorë ndërkombëtarë, në të cilat ata janë Palë.

2. Kjo Marrëveshje nuk do të aplikohet ndaj personave, subjekt të procedurave në lidhje me ekstradimin, ekstradimin në tranzit ose tranzitimin apo transferimin e personave të dënuar, pasi për këtë është rënë dakord midis shteteve të Palëve Kontraktuese ose midis tyre dhe shteteve të tretë.

Neni 14
Dispozita përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje përfundohet për një periudhë të papërcaktuar kohore.

2. Çdo Palë Kontraktuese do të njoftojë me shkrim Palën tjetër Kontraktuese, përmes kanaleve diplomatike, për përmbushjen e procedurave të nevojshme ligjore në shtetin e saj për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja do të hyjë në fuqi pas tridhjetë ditësh nga data e marrjes së njoftimit

të fundit.

3. Çdo Palë Kontraktuese mund ta pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, plotësisht ose pjesërisht, për arsye të mbrojtjes së rendit publik apo shëndetit publik, me anë të një njoftimi me shkrim të adresuar Palës tjetër Kontraktuese. Pezullimi do t'i njoftohet pa vonesë Palës tjetër Kontraktuese përmes kanaleve diplomatike dhe do të bëhet efektiv në datën e përmendur në njoftim.

4. Çdo Palë Kontraktuese, në çdo kohë, mund të propozojë ndryshime ose shtesa të kësaj Marrëveshjeje. Pasi Palët Kontraktuese do të bien dakord për një propozim të tillë dhe do të nënshkruajnë dokumentet, ato do të hyjnë në fuqi sipas paragrafit 2 të këtij neni.

5. Çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje me anë të një njoftimi me shkrim të adresuar Palës tjetër Kontraktuese. Denoncimi do të bëhet efektiv ditën e parë të muajit pasardhës të datës kur Pala tjetër Kontraktuese ka marrë këtë njoftim me shkrim.

6. Kjo Marrëveshje do të aplikohet ndaj të gjithë personave, qëndrimi i të cilëve në territorin e shteteve të Palëve Kontraktuese bëhet i paligjshëm, duke filluar me datën e hyrjes së saj në fuqi, dhe pas kësaj date, edhe ndaj personave të cilët do të hyjnë në mënyrë të paligjshme në territoret respektive pas kësaj date.

7. Apendiksi është pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Bukuresht me 7.6.2002 në dy kopje origjinale, në gjuhët shqip, rumanisht dhe anglisht, të gjitha tekstet autentikisht të njëjta. Në rast të ndryshimit të përkthimit, teksti anglisht do të merret për bazë.

L I G J
Nr. 8954, datë 17.10.2002

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË NORVEGJISË PËR ASISTENCË NË FINANCIMIN E SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS, PËR REHABILITIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E SISTEMEVE EKZISTUESE TË UJIT TË PIJSHËM DHE UJËRAVE TË ZEZA NË BURREL, NË QARKUN E DIBRËS"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e grantit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë për asistencë në financimin e shërbimeve të konsulencës, për rehabilitimin dhe përmirësimin e sistemeve ekzistuese të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza në Burrel, në qarkun e Dibrës".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3544, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

GRANTI NDËRMJET QEVERISË SË MBRETËRISË TË NORVEGJISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË NË LIDHJE ME ASISTENCË NË FINANCIMIN E SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS, MATERIALEVE DHE PAJISJEVE NË LIDHJE ME REHABILITIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E SISTEMEVE EKZISTUESE TË UJIT TË PIJSHËM DHE TË UJËRAVE TË ZEZA NË BURREL, NË QARKUN E DIBRËS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Pasi Qeveria e Republikës së Shqipërisë (Shqipëria) nëpërmjet Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të Republikës së Shqipërisë (Ministria) në letrën e datës 27.11.2001 i ka kërkuar asistencë Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë për rehabilitimin dhe përmirësimin e sistemeve ekzistuese të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza në Burrel, në qarkun e Dibrës të Republikës së Shqipërisë, dhe

Pasi Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë ka vendosur t'i përgjigjet kërkesës së bërë,

Atëherë, Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë kanë arritur në kuptimin e mëposhtëm që do të përbëjë një Marrëveshje midis Palëve:

Neni 1

Objektivat

1. Kjo Marrëveshje përcakton kushtet dhe procedurat për asistencën e Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë në rehabilitimin dhe përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë në qytetin e Burrelit, siç përshkruhet në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje ("Projekti").

Projekti përshkruhet më tej në dokumentin e Projektit të datës shtator 2001.

2. Qëllimi i Projektit është zhvillimi ekonomik dhe social i zonave të Projektit, duke u fokusuar në furnizimin me ujë, kushtet e ujërave të zeza, si dhe në përmirësimin e kushteve shëndetësore.

Objektivat e Projektit janë rehabilitimi dhe përmirësimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe të ujërave të zeza në një nivel të pranueshëm bashkëkohor sipas Strategjisë Kombëtare të Ujit të Republikës së Shqipërisë dhe rritjes së kapacitetit institucional të utiliteteve përgjegjëse për ujin.

Neni 2

Bashkëpunimi – Përfaqësimi – Administrimi

1. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar që qëllimet dhe objektivat e Projektit të realizohen me sukses. Për këtë efekt, secila Palë duhet t'i sigurojë Palës tjetër të gjithë informacionin e arsyeshëm të kërkuar në lidhje me Projektin.

2. Në çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia Norvegjeze e Bashkëpunimit për Zhvillim (ANBZH) dhe Ministria duhet të jenë kompetente për të përfaqësuar Norvegjinë dhe Shqipërinë, respektivisht.

Ministria, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Ujit, do të ketë të gjithë përgjegjësinë për zbatimin e Projektit.

Çdo shkëmbim informacioni me Norvegjinë në lidhje me këtë Marrëveshje duhet t'i drejtohet Ambasadës Mbretërore të Norvegjisë në Tiranë.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve duhet të lidhë kontratën e mëposhtme për zbatimin e Projektit.

- Kontratë (Kontrata e Konsulencës) me firmë konsulente norvegjeze (Konsulenti) në lidhje me: (i) koordinimin, rishikimin e Projektit, si dhe përgatitjen e kushteve të referimit dhe të dokumentacionit të tenderave për nënprojektet e veçanta; (ii) ofrojë konsulencë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujit në përzgjedhjen dhe negociimin e kontratave me furnizuesit norvegjezë; dhe (iii) supervizimi i zbatimit të nënprojekteve nga Konsulenti (Shërbimet e Konsulencës).

Kontrata e Konsulencës dhe amendamentet e saj duhet të aprovohen nga Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë përpara se të hyjë në fuqi.

- Kontratë (a) me kontraktues lokal (Kontrata e Kontraktuesit) për kryerjen e punëve të

rehabilitimit dhe përmirësimit të Projektit.

- Kontratë (a) (Kontrata e siguruesve) me sigurues lokal dhe norvegjez (Siguruesit) në lidhje me zbatimin e nënprojekteve.

- Drafti i Kushteve të Referimit dhe i dokumentacionit të tenderit të përmendura më lart duhet t'i jepen së pari Ministrisë dhe më pas Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë për aprovim.

4. ANBZH-ja do të lidhë kontratë me një konsulent në lidhje me misionet teknike dhe financiare, referuar nenit 9 pika 2. Konsulenti, gjithashtu, do të ndihmojë Drejtorinë e Përgjithshme të Ujit në rolin e saj si punëdhënëse në procesin e ndërtimit, p.sh. të asistojë në procesin e tenderit për Kontratën e Konsulencës, duke iu përmbajtur kushteve të referimit e cila duhet t'i dorëzohet për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës- Kanalizimeve. Kostoja e këtij konsulenti do të mbulohet nga ANBZH-ja, nëse është mbi apo nën subvencion.

5. Përfaqësues të Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë dhe Shqipërisë duhet, nëse nuk vendoset ndryshe gjatë fazës së zbatimit të Projektit, të takohen të paktën dy herë në vit (takimi gjashtëmujor) me qëllim që:

- të shqyrtojë ecurinë e Projektit;
- të diskutojë rishikime të mundshme të planeve dhe buxheteve të Projektit;
- të diskutojë propozime për zgjerimin e nënprojekteve aktuale ose të reja që do të përfshihen në Projekt;
- të aprovojë planet e punës dhe buxhetin;
- të diskutojë çështje ose probleme të veçanta të zbatimit të Projektit.

Dokumentacioni i specifikuar në nenin 7 pika 1 dhe 2 do të jenë baza e takimit gjashtëmujor.

Takimi gjashtëmujor do të thirret dhe kryesohet nga Ministria.

Të dy Palët mund të përfshijnë të tjerë që do të prezantohen në delegacion si këshillues ose vëzhgues.

Elementët kryesorë të diskutimeve dhe të gjitha vendimet e marra nga takimi gjashtëmujor do të regjistrohen në protokoll. Protokolli do të formulohet nga Ministria dhe do t'i dërgohet Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë për komente, jo më vonë se tre ditë pas takimit gjashtëmujor.

Kurdo që Qeveria e Mbretërisë të Norvegjisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë bien dakord për zgjatjen e nënprojekteve ose përfshirjen e nënprojekteve të reja, kjo duhet të regjistrohet; do të preferohej që regjistrimi të bëhej në protokollin e takimit gjashtëmujor.

Neni 3
Kontributet e Norvegjisë

Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë duhet t'i nënshtrohet urdhrave të Parlamentit dhe, në bazë të kushteve dhe procedurave të përcaktuara ose të cilave u referohet këtu, i mundëson Shqipërisë një ndihmë financiare që nuk duhet të kalojë 28 000 000 KNO (njëzet e tetë milion kroner norvegjez) "Granti", që do të përdoret ekskluzivisht për financimin e Projektit në periudhën e planifikuar 2002-2004.

1. Çdo interes i përfituar nga Granti mund të përdoret për të mirën e Projektit, si dhe bihet dakord mes Palëve në një dokument të shkruar.

2. Çdo fond që nuk përdoret plotësisht për një aktivitet mund, sipas marrëveshjeve të mëparshme mes Palëve, të përdoret për të mirën e aktiviteteve të tjera që përfshihen në Projekt.

3. Çdo fond i pashfrytëzuar dhe çdo rritje e pashfrytëzuar e interesit pas përfundimit të Projektit duhet t'i kthehet Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë.

Neni 4
Kontributet dhe detyrimet e Shqipërisë

Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të lehtësuar zbatimin me sukses të Projektit dhe duhet, si më poshtë:

1. Të ketë të gjithë përgjegjësinë për planifikimin, administrimin dhe zbatimin e Projektit, duke përfshirë të gjitha kategoritë e punëve, riparimeve dhe mirëmbajtjes së ndërtesave, pajisjeve, pjesëve të këmbimit, mallrave dhe materialeve që janë mundësuar në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

2. Të sigurojë që Granti të reflektohet në planet dhe veprimet e Ministrisë dhe që llogaria e

Projektit të mbahet në përputhje me metoda të pranuara.

3. Të sigurojë objektet, shërbimet dhe marrëveshjet e përcaktuara në Kontratën e Konsulencës dhe Kontratën (at) e Siguruesve dhe të sigurojë dokumentacionin e nevojshëm për Shërbimet e Konsulencës, të cilave iu referua në Kontratën e Konsulencës.

4. Të sigurojë personel të mjaftueshëm të kualifikuar lokal, si dhe burime financiare, të cilat mund të nevojiten përveç ndihmës për zbatimin me sukses të Projektit.

5. T'i sigurojë Konsulentit dhe Siguruesit (ve) dhe personelit të tyre akses në informacione dhe të dhëna, përfshirë vizita në zonën e Projektit, që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të siguruar përfundimin e suksesshëm të Projektit.

6. Të marrë masat e duhura për magazinimin e pajisjeve dhe të asistojë Siguruesin (it) në transportimin e pajisjeve në zonën e Projektit.

7. Të përjashtojë nga të gjitha taksat doganore, taksa, tatime dhe detyrime të tjera për të gjithë materialin dhe furnizimin e financuar nga Granti dhe të importuar në Shqipëri për të mirën e Projektit. Qeveria e Republikës së Shqipërisë merr përsipër pagesën e TVSH-së, duke e planifikuar në buxhetin e shtetit për Ministrinë.

8. Të paguajë ose të kërkojë heqjen e çdo lloj takse mbi të ardhurat ose takse tjetër personale qoftë në nivelin bashkiak, ose në nivelin e Republikës së Shqipërisë për personelin e huaj të Konsulentit (ve) dhe Siguruesit (ve) mbi pagesa që bëhen nga Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë, duke i planifikuar në Buxhetin e Shtetit për Ministrinë.

9. Të lëshojë të gjitha licencat e nevojshme të importimit, lejet e shkëmbimit me jashtë dhe leje ose viza që mund të kërkohen për zbatimin e Projektit.

10. Të sigurojë sigurinë e personelit në zonat e Projektit edhe gjatë shërbimeve.

11. Të informojë menjëherë Norvegjinë për çdo rrethanë që pengon ose rrezikon të pengojë zbatimin me sukses të Projektit.

12. Të asistojë përfaqësuesit e Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë në marrjen e lejeve për të vizituar çdo pjesë të zonës së Projektit për arsyen që lidhet me këtë Marrëveshje dhe të kontrollojë çdo të dhënë relevante, mallra dhe dokumente.

13. Në rast arresti ose burgimi, për çdo arsye të mundshme të çdo individi joqytetar, i cili është siguruar nga kjo Marrëveshje, ose të fillimit të ndjekjes penale kundër tyre, të njoftojë Ambasadën Norvegjeze sipas procedurave të përcaktura internacionale dhe, pa vonesë, t'i japë të drejtën Ambasadës Norvegjeze për të vizituar individin (ët) e arrestuar ose të burgosur.

14. Të sigurojë akses në zonat e ndërtimit dhe, nëse është e nevojshme, të sigurojë fonde për të mbuluar humbjet dhe çdo kompensim që nevojitet.

Neni 5
Prokurimi

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimit ndërmerr të bëjë të gjithë prokurimin e mallrave dhe shërbimeve për Projektin dhe është përgjegjëse për kontratat që do të lidhen. Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të tregojë etiketë shumë të lartë gjatë prokurimit dhe zbatimit të kontratës.

Kontratat me kontraktuesit lokalë dhe norvegjezë dhe me siguruesin lokal, referuar nenit 2 pika 3 që kalojnë shumën 100 00 KNO dhe çdo amendament i saj, duhet t'i dorëzohet Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë për aprovim përpara se të hyjë në fuqi.

Shuma e këtyre kontratave me më pak se 100 00 KNO, që i janë dorëzuar ANBZH-së për aprovim, nuk duhet të kalojë 1 milion KNO.

2. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë ose çdo përfaqësues i Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë nuk do të ketë detyrime ligjore ose financiare të asnjë lloji për dëmtime ose humbje të shkaktuara nga Palët Kontraktuese ose nga Palë të treta, si rezultat i veprimeve ose mungesës së veprimeve gjatë performancës së secilës Palë në kontrata ose nga nënkontraktuesit e tyre të detyrave të përcaktuara në kontratën përkatëse ose çdo nënkontratë.

3. Prokurimi duhet të bëhet mbi parime të pranuara gjerësisht dhe me metoda të mira prokurimi dhe në përputhje me metodat e Bankës Botërore mbi tenderat, duke përfshirë formatin e dokumentit të ofertës për blerjen e mallrave dhe në përputhje me kufirin e përcaktuar më lart në pikën 1. Ftesat për tender ose në bërjen e ofertave, si dhe kontratat e prokurimit duhet, respektivisht, të

përfshijnë një pikë që thotë që oferta për tender do të hidhet poshtë dhe kontrata do të anulohet në rast se për dhënien ose zbatimin e kontratës janë aplikuar metoda ilegale ose të korruptuara.

Asnjë ofertë, dhuratë pagesë apo benefit i çdo lloji, i cili mund të përbëjë një metodë ilegale ose të korruptuar, nuk duhet pranuar si në mënyrë direkte, ashtu dhe indirekte si nxitje ose lidhje dhe zbatim të kontratave të prokurimit. Çdo metodë e tillë do të jetë shkak për anulimin e kësaj Marrëveshjeje dhe/ose të kontratës përkatëse të prokurimit.

Të gjitha kontratat që do t'i dorëzohen Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë duhet të shoqërohen nga një deklaratë nga Ministria, në të cilën deklarohet që u është përmbajtur rregulloreve të mësipërme të prokurimit.

4. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, nëse i kërkohet, duhet t'i sigurojë Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë të gjithë dokumentacionin mbi praktikat e saj të prokurimit, si dhe të veprimeve të bëra dhe të sigurojë akses në të gjithë dokumentacionet dhe të dhënat përkatëse. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë mund të kërkojë akses në informacion gjatë çdo faze të prokurimit, edhe atëherë kur informacioni është vetëm për zyrtarët që bëjnë prokurimin. Ruajtja e këtij informacioni duhet të respektohet dhe informacioni duhet të bëhet publik pa patur pasoja negative mbi prokurimin.

5. Pajisjet dhe furnizimet që do të prokurohen nën këtë Marrëveshje dhe që do të përdoren nga Konsulenti (ët) për zbatimin e Shërbimeve të Konsulencës do të bëhen pronë e Drejtorisë së Përgjthshme të Ujësjellës-Kanalizimit ose bashkisë pas përfundimit të Shërbimeve të Konsulencës.

6. Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të sigurojë në legjislaturën e saj mjete të përshtatshme dhe efektive për të parandaluar dhe ndëshkuar metoda ilegale ose të korruptuara.

Neni 6
Pagesat

1. Pagesa për Shërbimin e Konsulencës do t'i bëhet Konsulentit direkt nga Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë, në përputhje me kushtet e Kontratës së Konsulencës, pas marrjes së faturave të siguruara nga Konsulenti dhe të vërtetuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Këshillit Norvegjes të Tregtisë (KNT), në përputhje me Marrëveshjen midis KNT-së dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze të datës 29 qershor 2000.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve duhet të lidhë një kontratë (Kontrata Tripalëshe) me ANBZH-në dhe Konsulentin në lidhje me shërbimet e zhbursimeve, që kanë të bëjnë me pagimin e Kontraktuesit (ve) dhe të Siguruesit (ve).

3. Pagesa e Kontraktuesve lokalë dhe siguruesve norvegjezë dhe lokalë të kontraktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Këshilli Norvegjez i Tregtisë do të bëhet direkt nga Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë nëpërmjet Konsulentit, në përputhje me kushtet e Kontratës Tripalëshe të lartpërmendur dhe pas marrjes së faturave të vërtetuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Konsulentit.

4. Të gjitha faturat duhet të kenë numrin e Projektit të ANBZH-së (ALB 2005) dhe numrin e Marrëveshjes (ALB 01.002).

Neni 7
Raporte

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'i dorëzojë Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë brenda 30 ditëve përpara takimit gjashtëmujor një raport gjashtëmujor mbi zbatimin e Projektit. Formati për raportin gjashtëmujor është dhënë në aneksin II.

Raporti gjashtëmujor do të përmbajë:

- raporte mbi ecurinë, që japin informacion mbi rezultatet aktuale të krahasuara me rezultatet e planifikuara, plane pune dhe kufijtë kohorë, përdorimi i inputeve, problemet e hasura apo të parashikuara dhe informacione të tjera në lidhje me zbatimin.
- llogari të Projektit që kanë të bëjnë me buxhetin, duke specifikuar të ardhurat nga të gjitha burimet dhe shpenzimet.

2. Si pjesë e përgatitjes së takimit gjashtëmujor i përmendur më sipër në nenin 2 pika 4, Qeveria e Republikës së Shqipërisë brenda 30 ditëve përpara takimit gjashtëmujor do t'i dorëzojë Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë:

- një plan pune të azhurnuar me rezultatet e planifikuara dhe kufijtë kohorë për secilin nënprojekt, përfshirë propozime për përfshirjen e nënprojekteve të reja në Projekt;

- buxhet të azhurnuar për Projektin, që tregon të gjitha shpenzimet për secilin nënprojekt.

Këto dokumente, së bashku me raportin gjashtëmujor do të sigurojnë themelet e diskutimit dhe të vendimeve që do të merren në takimin gjashtëmujor.

3. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'i sigurojë Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë një kopje të të gjitha raporteve që do të dorëzohen nga Konsulenti (ët) dhe Siguruesi (t) në përputhje me kushtet e përcaktuara në Kontratën e Konsulencës dhe Kontratën(at) e Siguruesit (ve), me aprovimin e Ministrisë dhe/ose komentet e saj. Raportet me aprovimin dhe/ose komentet do të dorëzohen brenda tre javëve pas marrjes së raporteve.

4. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'i dorëzojë Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë një raport përfundimtar brenda 6 muajve pas përfundimit të Projektit.

Raporti përfundimtar do të japë përmbledhje të rezultateve dhe aktiviteteve të ndërmarra, arritjet e krahasuara me qëllimet dhe objektivat dhe një vlerësim të efektivitetit të Projektit.

5. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë, jo më vonë se 40 ditë përpara takimit gjashtëmujor, do t'i dorëzojë Shqipërisë raporte mbi pagesat e bëra nga Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë në përputhje me nenin 6, më lart.

6. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë do të përgjigjet brenda 6 javëve pas marrjes së raporteve të lartpërmendura.

Neni 8
Rezervimet

1. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë rezervon të drejtën të tërheqë disbursimet në çdo kohë në rast:

- kur Projekti zhvillohet në mënyrë të papërshtatshme në lidhje me qëllimet dhe objektivat;
- kur ndodhin ndryshime të konsiderueshme nga planet mbi të cilat është rënë dakord;
- kur burimet që do të sigurohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk sigurohen siç është rënë dakord;
- kur dokumentacioni i specifikuar në nenin 7, më lart, nuk dorëzohet siç është rënë dakord;
- kur menaxhimi financiar i Projektit nuk është i kënaqshëm;
- kur kontratat të cilave iu referua në nenin 2 pika 3, më lart, prishen ose ndërpriten përpara se të plotësohen obligimet e përcaktuara në to.

2. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë rezervon të drejtën të kërkojë pagimin e plotë ose të pjesshëm të fondeve nga Granti, nëse konstatohet që fondet ose pjesë të fondeve nuk janë përdorur në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, ose nuk jepet llogari në mënyrë të kënaqshme.

3. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë do ta anulojë këtë Marrëveshje ose pjesë të kësaj Marrëveshjeje dhe ka të drejtën të kërkojë anulimin e çdo kontrate të financuar në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, me efekt të menjëhershëm nëse ajo përcakton, në lidhje me çdo kontratë të financuar në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, që përfaqësues të Shqipërisë kanë marrë pjesë në praktika të korruptuara dhe mashtruese ose të përfitimeve nga fondi i ndihmës gjatë prokurimit ose gjatë zbatimit të kontratës dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura, të kënaqshme për Norvegjinë për të rregulluar situatën.

4. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë bien dakord të bashkëpunojnë për të parandaluar korrupsionin në dhe gjatë Projektit. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë ndërmarrin të marrin masa të shpejta ligjore në vendet e tyre përkatëse për të ndaluar, investiguar dhe ndjekur ligjërisht në përputhje me ligjin e vendit çdo individ të dyshuar për korrupsion ose keqpërdorim tjetër të burimeve internacionale.

Neni 9
Informacion – Vlerësim – Rishikim

Rishikime të projekteve të përbashkëta të Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë dhe Shqipërisë mund të kryhen me kërkesën e secilës Palë.

Nëse nuk vendoset ndryshe gjatë zbatimit të Projektit, do të bëhen rishikimet që ndjekin:

Do të bëhet rishikim në mes të Projektit, nëse kjo vlerësohet e nevojshme nga Palët në kohën e vendosur nga Palët. Kostoja e rishikimit do të mbulohet nga Granti.

1. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë do të ketë të drejtën të kryejë çdo lloj misioni teknik ose financiar, të cilin ajo e konsideron të nevojshëm për vazhdimin e zbatimit të Projektit. Për të lehtësuar punën e individit ose individëve të udhëzuar për kryerjen e një misioni të tillë monitorues, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të sigurojë të gjithë asistencën, informacionin dhe dokumentacionin përkatës.

2. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë ka të drejtën e monitorimit dhe të vlerësimit pas përfundimit të një nënprojekti, si dhe të drejtën t'i kërkojë Shqipërisë një raport përfundimtar të nënprojektit.

Neni 10

Kundërshtimet – Hyrja në fuqi – Prishja e pikës

1. Nëse hasen kundërshtime që kanë të bëjnë me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, duhet të ketë konsultime midis autoriteteve kompetente të përcaktuara në nenin 2 pika 2 më sipër, me qëllimin e arritjes së Marrëveshjes. Në rastin e dështimit në arritjen e Marrëveshjes çështja duhet t'i kalohet Ministrisë së Punëve me Jashtë të Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e ratifikimit të saj nga Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë dhe do të qëndrojë në fuqi derisa të dy Palët të kenë plotësuar të gjitha detyrimet e përcaktuara në të. Nëse këto detyrime do të konsiderohen të plotësuara apo jo, kjo do të përcaktohet në konsultime midis Palëve.

3. Pavarësisht nga pika e mësipërme, të dyja Palët mund ta prishin marrëveshjen aktuale, duke i prezantuar Palës tjetër një njoftim të shkruar tremujor.

4. Në dëshmitë sa u tha më lart, i nënshkruari, duke vepruar në emër të qeverive të tyre përkatëse, nënshkruan këtë Marrëveshje në dy origjinale në gjuhën angleze.

SHTOJCË 1

PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT

Emri i Projektit	Rehabilitimi i sistemeve të ujit të pijshëm dhe të ujërave të zeza në Burrel, Shqipëri.
Institucioni zbatues:	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve e Shqipërisë
Qëllimi i Projektit:	Qëllimi i Projektit është zhvillimi ekonomik dhe social i zonave të Projektit, duke u fokusuar në nevojat themelore të furnizimit me ujë, kushteve sanitare dhe përmirësimi të kushteve shëndetësore.
Objektivat e Projektit:	Objektivat e Projektit janë rehabilitimi dhe përmirësimi i shërbimeve të ujit dhe të ujërave të zeza në një nivel aktual të pranuar gjerësisht të bazuar në Strategjinë Kombëtare të Ujit në Republikën e Shqipërisë dhe rritje të kapacitetit institucional të utiliteteve përgjegjëse të ujit.
Rezultatet:	Pas përfundimit të rehabilitimit, investimet i transferohen Autoriteteve të Ujit në Burrel, në gjendje funksionimi. Rutina të bazuara në EDB për kthimin e kostos me anë të vjeljes së taksave nga përdoruesit të vendosur për operacione të ardhshme, si dhe mirëmbajtjen e shërbimeve në të ardhmen. Ndërtimi i institucioneve nëpërmjet operacioneve tregtare të ujësjellësit.

Shqipëria: Kontribut në natyrë
Norvegjia: Deri 28.0 milion KNO
ZËRI – BURREL

(i) Rehabilitimi i sistemit të furnizimit me ujë	14.900.000
(ii) Rehabilitimi i sistemit të ujërave të zeza	5.600.000
(iii) Shërbime konsulente	6.000.000
(iiii) Shpenzime të paparashikuara	1.500.000
Totali	28.000.000

L I G J
Nr. 8955, datë 17.10.2002

PËR RATIFIKIMIN E "KONTRATËS FINANCIARE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE PËR PROJEKTIN E REHABILITIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË PORTIT TË DURRËSIT"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Kontrata financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin e rehabilitimit të infrastrukturës së Portit të Durrësit", me vlerë 17 000 000 (shtatëmbëdhjetë milionë) Euro.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3545, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

KONTRATA FINANCIARE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE I BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE
PORTI I DURRËSIT - PROJEKTI I REHABILITIMIT TË INFRASTRUKTURËS (SHQIPËRIA)

Kjo Kontratë lidhet ndërmjet: Republikës së Shqipërisë, e cila në këtë kontratë vepron nëpërmjet Ministrit të Financave dhe Ministrit të Transportit, të cilët përfaqësohen nga
që këtu e më poshtë do të quhet: "Huamarrësi".
Si Palë e parë, dhe
Bankës Europiane të Investimeve me zyra qendrore në Luksemburg, përfaqësuar nga
që këtu e më poshtë do të quhet: "Banka".
Si Palë e dytë.
Duke qenë se:

1. Huamarrësi në bashkëpunim me, dhe në të mirë të autoritetit portual Durrës sh.a. (një kompani aksionere, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, me vendim nr. 20385, datë 4.12.1998, që këtu e më poshtë do të quhet "APD"), propozon të ndërmarrë një projekt në portin e Durrësit (që këtu e më poshtë do të quhet "Projekti") për: (i) rehabilitimin e kalatave 4 deri 7 dhe kryerjen e punimeve përkatëse në breg; (ii) blerjen dhe instalimin e pajisjeve për trajtimin e ngarkesave kargo; dhe (iii) rindërtimin e dallgëthyesit perëndimor, siç është përshkruar më hollësisht në përmbledhjen që paraqitet në planin A (të cilit këtu e më pas do t'i referohemi me emrin "Përshkrimi i Projektit").

2. Kosto totale e Projektit, përfshirë fondin rezervë dhe interesin gjatë ndërtimit, por pa përfshirë taksat dhe detyrimet sipas vlerësimit të Bankës, është 34 000 000 euro (tridhjetë e katër milion euro), shumë kjo që do të financohet sipas planit financiar në vijim:

- fondet e Huamarrësit dhe financimet e palëve të treta, përveç atyre të përcaktuara më poshtë	2 500 000 euro
- granti nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin	1 500 000 euro
- huaja nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka Botërore")	13 000 000
	17 000 000

3. Për të plotësuar financimin e kërkuar, Huamarrësi ka kërkuar një hua nga Banka në shumën prej: 17 000 000 euro
34 000 000 euro

4. Projekti është pjesë përbërëse e një projekti më të madh rehabilitues për Portin e Durrësit, komponentët e të cilit të financuara nga Banka Botërore po zbatohen tashmë nga një njësi e financuar nga ajo (të cilës këtu e më pas do t'i referohemi "PIU i Bankës Botërore"), e cila është ngritur brenda Ministrisë së Transportit.

5. Është propozuar që një pjesë e huasë së Bankës Botërore do të përdoret për të financuar përgatitjen e dokumenteve të tenderit për disa komponentë të Projektit.

6. Marrëveshja kuadër që qeveris aktivitetet e Bankës Europiane të Investimeve në Shqipëri, nënshkruar më 5 shkurt 1998 nga Republika e Shqipërisë dhe Banka Europiane e Investimeve është e zbatueshme mbi këtë Kontratë.

7. Banka, duke qenë e kënaqur që aktiviteti aktual është brenda fushës së veprimtarisë së saj dhe duke patur parasysh çështjet e sipërpërmendura, ka vendosur të pranojë kërkesën e Huamarrësit për shumën 17 000 000 euro (shtatëmbëdhjetë milionë euro).

8. Zbatimi i kësaj kontrate në emër të Huamarrësit është autorizuar rregullisht, nëpërmjet një vendimi të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë në kushtet e paraqitura në aneksin I.

9.Referencat si citimet, nenet, paragrafët, nënparagrafët, planet dhe anekset, janë përkatësisht referime të citimeve, neneve, paragrafëve, nënparagrafëve, planeve dhe anekseve të kësaj Kontrate.

Për sa më lart, u ra dakord si më poshtë:

Neni 1
Disbursimi

1.01. Shuma e Kredisë

Nëpërmjet kësaj Kontrate, Banka jep në favor të Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon një kredi (më poshtë referuar si "Kredi") në një shumë prej 17 000 000 euro (shtatëmbëdhjetë milionë euro) për t'u përdorur ekskluzivisht për financimin e Projektit.

1.02. Procedurat e disbursimit

A) Deri në 28 dhjetor 2006, Huamarrësi mund t'i dërgojë Bankës, rregullisht, në varësi të përmbushjes së kushteve përkatëse të paragrafit 1.04, kërkesa me shkrim të firmosura (që do të quhen "Kërkesa disbursimi") për disbursimin e çdo pjese të Kredisë (secila pjesë e tillë do të quhet "Transh"), me kusht që (i) shuma e Transhit të parë do të jetë 3 000 000 euro dhe (II) shuma e çdo transhi do të jetë të paktën 3 000 000 euro (nëse bilanci i padisbursuar i kredisë, e lejon këtë)

B) Çdo kërkesë disbursimi do të specifikojë:

(a) shumën e kërkuar për disbursim nën këtë Transh;

(b) datën e preferuar të disbursimit dhe kjo nënkupton që Banka mund të disbursojë Transhin deri në katër muaj kalendarik nga data e kërkesës;

(c) preferencën e Huamarrësit në lidhje me datat normale të pagesës, që janë zgjedhur sipas paragrafit 5.03A, dhe kushtet e shlyerjes së Transhit, të cilat do të jenë në përputhje me paragrafin 4.01.

Me kusht që Huamarrësi mund të specifikojë, gjithashtu, përqindjen e aplikueshme të interesit, në qoftë se një përqindje e tillë është përcaktuar paraprakisht nga Banka, pa angazhim, siç aplikohet në Transh.

Sipas dispozitave të nënparagrafit 1.02C, çdo kërkesë disbursimi është e parevokueshme.

C) Pesëmbëdhjetë deri dhjetë ditë para datës së disbursimit, nëse kërkesa është në përputhje me nënparagrafët 1.02 A dhe 1.02 B dhe me paragrafët 1.04 dhe 1.06, Banka do t'i dërgojë një njoftim Huamarrësit (që këtu e më pas do t'i referohemi me emrin "Njoftimi i disbursimit") i cili do të specifikojë:

(a) shumën e Transhit të specifikuar në kërkesën e disburismit;

(b) datën e disbursimit të Transhit;

(c) datat normale të pagesës dhe kushtet e aplikueshme të ripagesës; dhe

(d) përqindjen e aplikueshme të interesit sipas paragrafit 3.01.

Në qoftë se përqindja e interesit të specifikuar në njoftimin e disbursimi tejkalon përqindjen përkatëse të përcaktuar më parë nga Banka dhe të deklaruar në kërkesën e disbursimit, ose nëse ndonjë

nga elementet e tjera të përmendura në njoftimin e disbursimit nuk përputhet me elementet që i korrespondojnë në kërkesën e disbursimit, Huamarrësi mund të revokojë kërkesën e disburismit duke njoftuar Bankën, brenda tre ditëve gjatë të cilave Banka është e hapur në Luksemburg, që nga marrja e njoftimit të disbursimit, dhe pas kësaj kërkesa përkatëse e disbursimit dhe njoftimi i disbursimit nuk do të kenë më efekt.

D) Disbursimi do të bëhet në atë llogari të Huamarrësit pranë Bankës së Shqipërisë, për të cilën Huamarrësi do të njoftojë Bankën jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së rimbursimit.

1.03. Monedha e disbursimit

Banka do të disbursojë çdo Transh në euro; megjithatë Banka do të bëjë disbursime në USD, nëse kërkohet kështu nga Huamarrësi dhe nëse disbursimi në këtë monedhë është i disponueshëm.

Për llogaritjen e shumës ekuivalente në euro për secilin Transh që do të disbursohet në USD, Banka do të aplikojë kursin e këmbimit të përcaktuar nga Banka Qendrore Europiane për këtë monedhë, në një nga 15 ditët para këtij disbursimi, që do të vendoset nga Banka (ose në mungesë, do të përdoret një kurs këmbimi i atij tregu financiar që do të zgjidhet nga Banka.

1.04. Kushtet paraprake të kërkesës së disbursimit

A) Disbursimi i Transhit të parë, në përputhje me paragrafin 1.02, do t'i nënshtrohet përmbushjes së kushteve të mëposhtme që kërkon Banka, në ose përpara datës së kërkesës së parë të disbursimit, domethënë:

a) Banka do të ketë marrë një opinion ligjor në gjuhën angleze, lëshuar nga ose në emër të Ministrit të Drejtësisë së Shqipërisë, i cili konfirmon që dispozitat e kësaj Kontrate janë plotësisht në fuqi dhe efektive dhe se kjo Kontratë është e vlefshme, e detyrueshme dhe në fuqi në Shqipëri, në përputhje me kushtet e saj.

b) Të gjitha aprovimet e nevojshme mbi kontrollin e këmbimit (nëse ka), duhet të sigurohen për të lejuar Huamarrësin të marrë disbursimet këtu e më poshtë dhe të ripaguajë huanë (siç është përcaktuar në paragrafin 2.01) dhe të paguajë interesat dhe të gjitha shumat e tjera, që vijnë nga detyrimet e tjera; këto aprovime bëhen për të zgjeruar hapjen dhe administrimin e llogarive, në të cilat Huamarrësi drejton Bankën për disbursimin e kredisë.

c) APD-ja (me aprovimin e Bordit Mbikëqyrës) dhe Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrisë së Transportit të Huamarrësit duhet të bien dakord, secila me shkrim që: (i) përgjegjësia e vetme për zbatimin e Projektit është e kësaj të fundit, e cila vepron përmes PIU-t, së cilës i referohet paragrafi 6.08; dhe (ii) që APD-ja do t'i ofrojë mbështetjen e nevojshme për këtë PIU-t, në përputhje me një memorandum mirëkuptimi, i cili përcakton rolet dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Transportit, APD dhe PIU-t, dhe do të emërojë një person për të ndërmjetësuar me të, në mënyrë që të sigurojë zbatimin e kënaqshëm të Projektit.

d) Banka duhet të marrë evidencë që demonstron që PIU, së cilës i referohet paragrafi 6.08, është krijuar në përputhje me këtë paragraf.

e) PIU, të cilit i referohet paragrafi 6.08, do të hartojë një plan për zbatimin e Projektit, i cili trajton projektimin, prokurimin, mbikëqyrjen dhe asistencën teknike për komponentët e financuar nga Banka.

f) Ministria e Transportit e Huamarrësit do të futet në një kontratë të asistencës teknike, së cilës i është referuar në paragrafin 6.09.

g) Një studim mjedisor i komponentit të punimeve për dallgëthyesin, i përfshirë në Projekt, duhet të jetë kryer dhe për çdo efekt negativ mbi mjedisin që është identifikuar në këtë studim. PIU duhet të ketë përcaktuar masat, me anë të të cilave do të zbutet një efekt i tillë.

h) Banka do të marrë evidencë për autoritetin e personave të autorizuar për të nënshkruar dhe miratuar kërkesat e disbursimit dhe specimenet autentike të këtij personi ose personave.

Nëse kërkesa e disbursimit për disbursimin e Transhit të parë është bërë para se Banka të marrë evidencën që demonstron, që të gjitha kushtet e specifikuara në nënparagrafin 1.04 A janë përmbushur sipas kërkesave të saj. Kërkesa të tilla disbursimi do të konsiderohen si të marra nga Banka në datën kur të gjitha këto kushte të jenë plotësuar.

B) Disbursimi në këtë Kontratë i secilit Transh, që nuk është as i pari dhe as i fundit, do të jetë subjekt i marrjes nga Banka në, ose përpara datës përkatëse të kërkesës së disbursimit dhe brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 8.01 pika (a), nënpika (i) evidencën që përmendet në (i) të asaj

pike.

C) Disbursimi i Transhit të fundit nën këtë Kontratë do të jetë subjekt ndaj marrjes prej Bankës në, ose përpara datës përkatëse të kërkesës së disbursimit, evidencë të pranueshme për të, me kusht që shuma totale e Transhit të fundit që do të disbursohet dhe e të gjithë Transheve të disbursuara nën këtë Kontratë nuk tejkalon shumën totale të të gjithë shpenzimeve (shumën neto të taksave dhe detyrimeve të pagueshme në Shqipëri), të shkaktuara nga Huamarrësi për komponentë të Projektit, të cilët në përshkrimin e Projektit përmenden si të financuara nga Banka.

D) Për llogaritjen në euro të shumave të shpenzuara, Banka do të aplikojë kursin e këmbimit të aplikuar tridhjetë ditë përpara datës së kërkesës së disbursimit.

E) Në qoftë se ndonjë pjesë e evidencës së siguruar nga Huamarrësi, sipas nënparagrafit 10.4 B ose 1.04 C nuk është e kënaqshme për Bankën, Banka mund të veprojë ose në përputhje me fjalinë e fundit të nënparagrafit 1.04 A, ose do të disbursojë proporcionalisht më pak sesa shuma e kërkuar për Transhin.

1.05. Vonesat

Në qoftë se disbursimi i ndonjë Transhi vonohet plotësisht ose pjesërisht me kërkesën e Huamarrësit (me aprovimin e Bankës), Huamarrësi do të paguajë komisionin për vonesën mbi pjesën e padisbursuar të Transhit, që përllogaritet në një përqindje vjetore prej 1% (një për qind) nga data e disbursimit, për të cilën është rënë dakord fillimisht deri në datën e disbursimit aktual ose, sipas rastit, në datën e anulimit ose pezullimit të Kredisë.

Çdo kërkesë për vonesë duhet të merret nga Banka së paku tetë ditë para datës së disbursimit të planifikuar fillimisht.

Një komision i tillë do të akumulohet ditë për ditë dhe do të paguhet në çdo datë normale të pagesës, siç përcaktohet në nënparagrafin 5.03 A, ose në rast se përllogaritet në lidhje me një pjesë të anuluar të Kredisë, në momentin e pagesës së komisionit që paguhet sipas paragrafit 1.08.

1.06. Anulimi

Nëse kostoja e Projektit do të jetë më e vogël se shifrat e deklaruara në Citime Banka, pasi të njoftojë Huamarrësin, mund të anulojë Kredinë në proporcion me deficitin (në këtë rast Huamarrësi nuk është i detyruar të paguajë komision për anulim).

Huamarrësi mundet në çdo kohë, duke njoftuar Bankën, të anulojë tërësisht ose pjesërisht çdo pjesë të padisbursuar të Kredisë, me kusht që, në qoftë se Huamarrësi anulon ndonjë Transh që ka qenë subjekt i një njoftimi disbursimi, që nuk është revokuar sipas nënparagrafit 1.02 C, ai do të paguajë një komision të përllogaritur mbi shumën e anuluar në një përqindje fikse, që është e barabartë me gjysmën e përqindjes së interesit që është e zbatueshme mbi një Transh të tillë. Një komision i tillë do të jetë i pagueshëm bashkë me çdo komision tjetër të vonesave që është i pagueshëm sipas paragrafit 1.05.

Pjesa e padisbursuar e Kredisë do të konsiderohet e anuluar nëse Banka kërkon parapagesë sipas nënparagrafit 4.03 C.

Banka, duke njoftuar Huamarrësin, mundet të anulojë menjëherë çdo pjesë të shumës së padisbursuar të Kredisë, për të cilën deri më 28 dhjetor 2006 nuk është bërë kërkesë disbursimi.

1.07. Pezullimi dhe ndërprerja

Nëpërmjet një njoftimi me shkrim, Banka mund të pezullojë të gjithë ose një pjesë të shumës së padisbursuar të Kredisë në çdo kohë dhe menjëherë:

(a) kur ndodh ndonjë nga ngjarjet e përmendura në nenin 10; ose

(b) kur krijohen rrethana të paparashikuara të cilat, sipas mendimit të Bankës, mund të pengojnë hyrjen e Bankës në tregjet përkatëse ndërkombëtare të kapitalit, me kusht që Banka nuk do të ketë të drejtë të pezullojë mbi bazën e pikës (b) ndonjë Transh i cili ka qenë subjekt i një njoftimi disbursimi.

Megjithatë, kur një ngjarje e përshkruar në pikat (a) ose (b) më sipër ka ndodhur, dhe sipas mendimit të Bankës, është e përkohshme, Banka, pasi njofton Huamarrësin, mund të pezullojë tërësisht ose pjesërisht shumën e padisbursuar të Kredisë. Nëse në një rast të tillë disbursimi i një Transhi nuk mund të realizohet për arsye të pezullimit, kërkesa përkatëse e disbursimit do të konsiderohet si e pabërë. Pezullimi i çdo pjese të kredisë do të vazhdojë deri sa Banka të njoftojë Huamarrësin që është përsëri në gjendje të lëshojë një njoftim disbursimi në lidhje me këtë pjesë të Kredisë ose që kjo pjesë e Kredisë është ndërprerë.

Pjesa e Kredisë që nuk është disbursuar, do të konsiderohet e anuluar në qoftë se Banka

kërkon parapagesën sipas nenit 10.

Në qoftë se Kredia është anuluar, ose është konsideruar si e anuluar nga Banka, duke u bazuar në pikën (a) më sipër, Humarrësi do të paguajë një komision mbi shumën e anuluar të çdo Transhi të padisbursuar, i cili ka qenë subjekt i një njoftimi disbursimi, në një normë vjetore 0.75% (zero pikë shtatëdhjetë e pesë për qind), e llogaritur nga data e njoftimit përkatës të disbursimit deri në datën e anulimit.

1.08. Monedha e Komisioneve

Komisionet që Huamarrësi duhet t'i paguajë Bankës sipas neni 1 do të llogariten dhe do të paguhen në euro.

Neni 2
Huaja

2.01. Shuma e Huasë

Huaja (më poshtë referuar si "Huaja") do të përfshijë totalin e të gjtha shumave të disbursuara nga Banka për Huamarrësin, në monedhat e lëvruara nga Banka, siç është njoftuar me shkrim nga Banka, për çdo disbursim.

2.02. Monedha e shlyerjes së Huasë

Secila shlyerje e një Transhi sipas nenit 4, ose sipas rastit nenit 10, do të realizohet në monedhën e disbursimit të tij.

2.03. Monedha e interesit dhe detyrimeve të tjera

Intereresi dhe detyrimet e tjera të pagueshme për çdo Transh, sipas paragrafit 3.01 neni 4 ose, kur është i zbatueshëm, sipas nenit 10, do të llogaritet dhe paguhet në monedhën në të cilën do të shlyhet Transhi.

Çdo pagesë tjetër do të bëhet në monedhën e përcaktuar nga Banka, duke patur parasysh monedhën e shpenzimeve që do të rimbursohen me anë të asaj pagese.

2.04. Njoftimi nga Banka

Pas disbursimit të çdo Transhi, Banka do t'i dërgojë Huamarrësit një pasqyrë përmbledhëse që konfirmon shumën, monedhën, datën e disbursimit, datat normale të pagesës, planin e shlyerjes dhe normën e interesit për këtë Transh.

Neni 3
Interesi

3.01. Norma e interesit

Bilanci i papaguar i ndonjë Transhi do të mbajë interesin në normën e përcaktuar në njoftimin përkatës të disbursimit, normë e cila do të jetë norma e interesit e aplikueshme në datën e nxjerrjes së njoftimit të disbursimit për huatë e emërtuara në monedhat e Transhit të financuara nga Banka për Huamarrësit e saj në të njëjtat kushte shlyerjeje dhe në të njëjtat kushte për pagesën e interesit si për Transhin në fjalë.

Interesi do të paguhet çdo gjashtëmujor në shumat përcaktuara në çdo datë normale të pagesës, siç është përcaktuar në nënparagrafin 5.03 A.

3.02. Interesi mbi shumat e maturuara

Pa prekur nenin 10 dhe në lidhje me çdo shumë të shlyeshme të Huasë, me përjashtim të paragrafit 3.01, interesi do të akumulohet mbi çdo shumë të maturuar nga data e maturimit, deri në datën aktuale të pagesës që llogaritet si më poshtë:

(a) për një shumë të pagueshme për secilin Transh në monedhën e disbursimit, me një normë vjetore të barabartë me: (i) 2.5% (dy pikë pesë për qind) të shumës; dhe (ii) përqindjen norma e aplikuar mbi Transhin sipas paragrafit 3.01; dhe

(b) për çdo shumë tjetër, me një normë vjetore të barabartë me: (i) 2.5% (dy pikë pesë për qind) të shumës; dhe (ii) përqindjen e interesit të aplikueshme për huatë e dhëna nga Banka në datën e maturimit Huamarrësve të njëjtë në monedhën e asaj shume, me pagesë gjashtëmujore të interesit për një periudhë 20-vjeçare.

Ky interes paguhet me të njëjtën monedhë si shuma e maturuar mbi të cilën llogaritet.

Neni 4
Shlyerja

4.01. Shlyerja normale

Huamarrësi do të shlyejë çdo Transh me këste të barabarta gjashtëmujore të principalit, në datat normale të pagesës përcaktuar në deklaratën përmbledhëse, e cila paraqitet sipas paragrafit 2.04 në përputhje me kushtet e planit të shlyerjes, të përcaktuara në të (plan ky i cili do të jetë pjesë përbërëse e kësaj kontrate).

Data e parë e shlyerjes që aplikohet për çdo Transh do të jetë brenda një periudhe prej 5 1/2 vitesh nga data e disbursimit të tij dhe data e fundit e shlyerjes së tij nuk duhet të jetë brenda katër vjetëve, ose pas kalimit të 20 vjetëve, nga ajo datë.

4.02. Parapagimi vullnetar

A) Huamarrësi mund të parapaguajë të gjitha ose një pjesë të ndonjë Transhi, në çdo vit duke njoftuar me shkrim (më poshtë referuar si "Njoftim parapagimi") dhe duke përcaktuar Transhin dhe shumën që do të parapaguhet, si dhe datën e propozuar të parapagimit ("Data e parapagimit"), e cila do të jetë një datë normale pagese, siç përcaktohet në deklaratën përmbledhëse, e cila paraqitet sipas paragrafit 2.04.

Njoftimi i parapagimit do t'i dërgohet Bankës të paktën një muaj përpara datës së përcaktuar të parapagimit. Parapagimi do të jetë subjekt i pagesës për Bankën të kompensimit, nëse ka, të përcaktuar sipas dispozitave të nënparagrafit 4.02 B që vijon.

B) Shuma e kompensimit të detyrueshëm mbi Transhin që do të parapaguhet do të jetë totali i shumave që përfaqësojnë zbritjen në interes që shkaktohet nga Banka në lidhje me secilën periudhë (pas datës së parapagimit), që fillon nga një datë e cila është (ose do të kishte qenë) një datë normale pagese dhe që përfundon në datën e ardhshme normale të pagesës, llogaritur dhe zbritur në përputhje me këtë nënparagraf.

Për secilën nga këto periudha, zbritja do të llogaritet si shuma, nëse ka, nga ku:

(i) interesi që duhej paguar gjatë asaj periudhe për pjesën e Transhit duhet parapaguar në përqindjen përkatëse të aplikueshme sipas paragrafit 3.01. përveç;

(ii) interesit që duhej paguar mbi një pjesë të tillë gjatë asaj periudhe në qoftë se llogaritet sipas normës që është 15 pikë bazë poshtë asaj të përcaktuar nga Banka në datën e një muaji përpara datës së parapagimit që do të jetë norma standarde për hua të dhëna nga burimet e vetë Bankës, të cilat kanë të njëjtat karakteristika financiare si Transhi, sidomos lidhur me monedhën e tyre, frekuencën e pagesës së interesit, kohën e mbetur deri në maturim dhe profilin e shlyerjes gjatë kësaj kohe (duke supozuar që nuk ka parapagim).

Çdo shumë e llogaritur kështu do të zbritet në datën e parapagesës, duke aplikuar një përqindje zbritjeje, që është e barabartë me normën standarde fikse të interesit, të cilës i është referuar në pikën (ii) të këtij nënparagrafi.

C) Banka do të lajmërojë Huamarrësin në një ditë pune në Tiranë për çdo shumë kompensimi që duhet paguar sipas nënparagrafit 4.02 B ose sipas rastit për mungesën e një kompensimi të tillë. Njoftimi i parapagesës nga Huamarrësi nuk do të ketë efekt në qoftë se Banka nuk ka marrë pranimin me shkrim të Huamarrësit për shumën e kompensimit, që i është njoftuar, nëse ka një kompensim të tillë, jo më vonë se ora 17.00 (i) në datën kur Huamarrësi merr njoftimin e lartpërmendur nga Banka; ose (ii) nëse Huamarrësi e ka marrë njoftimin pas orës 12.00, të nesërmen e asaj dite që është ditë pune në Luksemburg.

Për sa thuhet më lart, Huamarrësi është i detyruar të bëjë efektive pagesën me anë të njoftimit të parapagesës, bashkë me ndonjë kompensim që mund të jetë i detyrueshëm nën këtë paragraf 4.02.

4.03. Parapagesa e detyrueshme

A) Në qoftë se kostoja totale e Projektit do të jetë në mënyrë të konsiderueshme më e ulët se shifra e deklaruar në citimet, Banka mund të kërkojë parapagimin e huasë në proporcion me zbritjen.

B) Në qoftë se Huamarrësi parapaguan vullnetarisht një pjesë ose tërësisht një hua tjetër, që fillimisht është kontraktuar për një afat më shumë se 5 vjet, Banka mund të kërkojë parapagesën e asaj pjese të huasë që ka mbetur pa paguar, aq sa shuma e parapaguar është në krahasim me shumën totale të të gjithë huave të lidhura nga Huamarrësi.

Banka mund t'ia adresojë kërkesën e saj, nëse ka, Huamarrësit brenda 4 javëve pas marrjes së njoftimit përkatës sipas nënparagrafit 8.02 (a). Çdo shumë e kërkuar nga Banka do të paguhet bashkë

me interesin e akumuluar dhe shumën e kompensimit, nëse ka, të përllogaritur sipas nënparagrafit 4.02 B, mbi secilin Transh që duhet parapaguar, datën e treguar nga Banka, datë e cila nuk do t'i paraprijë datës së parapagesës së huasë tjetër.

Parapagesa e një huaje nëpërmjet një huaje të re, që ka një afat të paktën sa afati i paskaduar i huasë së parapaguar, nuk do të konsiderohet si parapagesë

C) Në qoftë se Huamarrësi informon Bankën sipas nënparagrafit 8.02 pika (b) se ka ndodhur ose ka të ngjarë të ndodhë një ngjarje e ndryshimit të kontrollit (siç përkufizohet këtu e më pas), ose në qoftë se Banka ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se një ngjarje e ndryshimit të kontrollit ka ndodhur ose do të ndodhë, Banka mund të kërkojë që Huamarrësi të konsultohet me të. Një konsultim i tillë duhet të kryhet brenda 30 ditësh nga data e kërkesës së Bankës.

Në qoftë se përpara (a) kalimit të tridhjetë ditëve nga data e kërkesës së Bankës, ose (b) ngjarjes së ndryshimit të kontrollit, Banka është e mendimit që një ndryshim i tillë i kontrollit ka ose ka të ngjarë të ketë një efekt negativ material mbi shërbimin në të ardhmen të huasë, Banka mund t'i kërkojë Huamarrësit të parapaguajë huanë bashkë me interesin e akumuluar dhe një shumë kompensimi, nëse ka, të llogaritur sipas nënparagrafit 4.02 B mbi secilin Transh për t'u parapaguar. Huamarrësi do të realizojë pagesën e shumës së kërkuar në datën e kërkuar nga Banka, datë kjo që nuk duhet të jetë më herët se 30 ditë nga data e kërkesës.

Me kusht që në funksion të kësaj Kontrate një "ngjarje e ndryshimit të kontrollit" është përvetësimi nga një person fizik apo juridik, ose një grup personash të tillë që veprojnë në bashkëpunim, të pushtetit për të emëruar dhe/ose hequr të gjithë ose pjesën më të madhe të anëtarëve të bordit të drejtorëve, ose ndonjë organi tjetër administrativ të APD-së, me ose pa ushtrimin e të drejtave të votës së aksionerëve në mbledhjen e përgjithshme të APD-së dhe/ose të ndonjë personi tjetër juridik.

4.04. Dispozita të përgjithshme lidhur me parapagesën sipas nenit 4

Në rast të një parapagese të pjesshme të një Transhi, shuma e parapaguar do të aplikohet në zbritje proporcionale të secilit prej kësteve të papaguar.

Neni 4 nuk do të cenojë nenin 10.

Neni 5
Pagesat

5.01.Vendi i pagesës

Çdo shumë për t'u paguar nga Huamarrësi sipas kësaj Kontrate do të paguhet në llogarinë përkatëse të caktuar nga Banka.

Banka do të caktojë llogarinë jo më vonë se 15 ditë para datës së pagesës së parë nga Huamarrësi dhe do të njoftojë për çdo ndryshim të llogarisë jo më vonë se 15 ditë përpara datës së pagesës së parë, në të cilën aplikohet ndryshimi. Kjo periudhë e njoftimit nuk do të aplikohet në rastin e pagesës sipas nenit 10.

5.02.Llogaritja e pagesave lidhur me një pjesë të vitit

Çdo shumë për t'u paguar që lidhet me interesin, komisionin ose tjetër, për një pjesë të vitit, do të llogaritet në bazë të një viti me 360 ditë dhe një muaji prej 30 ditësh.

5.03. Datat e pagesës

A) Shumat e interesit për t'u paguar mbi çdo Transh do të paguhen çdo vit në datat, të cilat tregohen për këtë qëllim në deklaratën përmbledhëse përkatëse, që paraqitet sipas paragrafit 2.04 (secila prej këtyre datave është "datë normale pagese"), të cilat duhet të përkojnë me:

(i) ditën e pestë, dhjetë, pesëmbëdhjetë, ose të njëzetë të çdo muaji; ose

(ii) ditën e njëzetepestë ose të fundit të muajit përveç dhjetorit.

B) Shumat e principalit për t'u shlyer mbi çdo Transh paguhen në çdo datë normale pagese të përcaktuar për këtë qëllim në deklaratën përmbledhëse përkatëse, që paraqitet sipas paragrafit 2.04.

C) Në qoftë se në ndonjë vit një shumë për t'u paguar, sipas kësaj Kontrate, që mund të jetë interes ose shlyerje, do të paguhet në një ditë kur sistemi ndëreuropian ekspres i transfertave (Target) nuk është hapur, kjo shumë do të paguhet në një datë normale pagese, që do të jetë dita e ardhshme kur Target është hapur. Në këtë rast, mbi shumat që do të paguhen nuk do të bëhen rregullime.

Çdo pagesë që është e detyrueshme në ndonjë monedhë tjetër e në një datë të caktuar, që nuk është ditë pune, në qendrën kryesore financiare të vendit, monedha kombëtare e të cilit është monedha

e shumës që duhet të shlyhet, do të paguhet në ditën më të parë të punës të një qendre të tillë kryesore financiare.

D) Në qoftë se nuk kushtëzohet ndryshe në këtë Kontratë, shumat e tjera të papaguara duhet të paguhen brenda shtatë ditëve, pas marrjes nga Huamarrësi të kërkesës së Bankës.

E) Një shumë për t'u paguar nga Huamarrësi do të konsiderohet e paguar kur të merret nga Banka në llogarinë përkatëse, që është njoftuar prej saj, sipas paragrafit 5.01.

Neni 6
Sipërmarrje të veçanta

6.01. Përdorimi i huasë dhe fondeve të tjera

Huamarrësi do të përdorë shumat e huasë dhe fonde të tjera të përmendura në planin financimit të përshkruar në citimin e dytë, ekskluzivisht për zbatimin e Projektit.

6.02. Përfundimi i Projektit

Huamarrësi do të sigurojë që Ministria e tij e Transportit, e cila vepron nëpërmjet njësisë së zbatimit të Projektit dhe me mbështetjen nga APD-ja, do të kryejë Projektin në përputhje me, dhe ta përfundojë atë në datën e specifikuar në përshkrimin e Projektit, siç mund të modifikohet herë pas here me miratimin e Bankës.

6.03. Kosto e rritur e Projektit

Në qoftë se kosto e Projektit tejkalon shifrën e përllogaritur dhe të shpallur në citimin e dytë, Huamarrësi do të sigurojë që Ministria e tij e Transportit të gjejë burimet e nevojshme financiare për të financuar kostot shtesë, pa i kërkuar gjë Bankës, në mënyrë që të mundësojë Huamarrësin të përfundojë Projektin në përputhje me përshkrimin e Projektit. Planet e Huamarrësit për financimin e kostove shtesë duhet t'i paraqiten periodikisht Bankës për aprovim.

6.04. Procedura e tenderit

Huamarrësi do të sigurojë që për Projektin të blihen pajisje, të sigurohen shërbime dhe të porositen punimet, sipas pëlqimit të Bankës dhe aq sa të jetë e përshtatshme dhe e mundshme nëpërmjet tenderave ndërkombëtarë të hapur për vendasit dhe shtetas të të gjithë vendeve. Në veçanti, Huamarrësi do të sigurojë që, para tenderimit të punimeve civile, pajisjeve ose shërbimeve për komponentët e Projektit që do të financohen nga Banka, Ministria e tij e Transportit, e cila vepron nëpërmjet njësisë së zbatimit të Projektit, do t'i transmetojë Bankës dokumentacion të kënaqshëm dhe të plotë për tenderat, duke përfshirë Projektin e detajuar inxhinierik të këtij Projekti. Përpara se të hyjë në ndonjë kontratë prokurimi, Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës për miratim tekstin për një kontratë të tillë.

6.05. Sigurimi

Huamarrësi do të sigurojë që të gjitha punimet dhe pronat, të cilat janë pjesë përbërëse të Projektit, të sigurohen siç duhen në përputhje me praktikën normale për punime të ngjashme të interesit publik.

6.06. Mirëmbajtja

Huamarrësi do të sigurojë që APD-ja do të mirëmbajë, riparojë dhe rinovojë të gjithë pronën, që është pjesë përbërëse e Projektit, siç kërkohet për ta mbajtur atë në gjendje të mirë pune dhe do të hyjë në kontrata të përshtatshme, të pëlqyeshme për Bankën, për mirëmbajtjen e pajisjeve që financohen nga kjo e fundit.

6.07. Funksionimi i Projektit

Po qe se Banka nuk parashikon ndryshe me shkrim, Huamarrësi do të sigurohet që ai dhe, sipas rastit APD-ja do të posedojë aktivet që përbëjnë Projektin, do të zëvendësojë dhe rinovojë aktive të tillë dhe që APD-ja do të mirëmbajë Projektin në kushte të tilla funksionimi në përputhje me qëllimin e tij fillestar.

Banka mund të mos japë pëlqimin e saj, vetëm kur veprimet e propozuara cenojnë interesat e Bankës si Huadhënës i Huamarrësit, ose mund të bëjë që Projekti ta humbë ligjshmërinë e tij për t'u financuar nga Banka.

6.08. Njësia e zbatimit të Projektit

Huamarrësi do të sigurojë që gjatë gjithë periudhës së zbatimit të Projektit në Ministrinë e Transportit të funksionojë një njësi e zbatimit të Projektit, e cila do të:

(i) pajiset siç duhet dhe të ketë personelin e kualifikuar sipas kërkesës së Bankës dhe të

vendoset në një vend të tillë që t'i japë mundësi të punojë në mënyrë të integruar me PIU-n e Bankës Botërore;

(ii) besohet koordinimi i zbatimit të Projektit me mbështetjen e firmës së konsulentit, të kontraktuar sipas paragrafit 6.09, për të mbuluar të gjitha fazat e zbatimit të komponentëve të Projektit që financohen nga Banka, përfshirë përgatitjen e një përkufizimi të hollësishëm të Projektit finalizimin e Projektimit, dokumenteve të tenderit, vlerësimin e tenderit dhe zgjedhjen e fituesve, dhënien e kontratave, si dhe administrimin e Projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve;

(iii) raportojë direkt para Ministrit të Transportit dhe do të përgjigjet vetëm para këtij Ministri;

(iv) veprojë si homologu i Bankës në të gjitha çështjet teknike, administrative dhe të raportimit.

6.09. Asistenca teknike

Huamarrësi do të sigurojë që Ministria e tij e Transportit të futet në një kontratë të asistencës teknike me një firmë ndërkombëtare konsulence, kualifikimi dhe përvoja ndërkombëtare e të cilës në punime civile dhe termat e referencës do të jenë të pëlqyeshme për Bankën. Kjo Kontratë do të jetë në fuqi gjatë gjithë periudhës deri në përfundimin e Projektit; firma e konsulentit do të sigurojë, sipas nevojës, asistencë për PIU- n për çdo projektim, studim apo çështje tjetër kontraktuale të pazgjidhur dhe do të sigurojë administrimin e përgjithshëm të Projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve civile për përfundimin në kohë të Projektit.

Huamarrësi gjithashtu do të sigurojë që Banka do të mundet të kontaktojë direkt e në çdo kohë konsulentët përkatës.

6.10. Marrëveshjet ambientale

Huamarrësi do të sigurojë që:

(a) PIU dhe APD-ja do të marrin në kohë çdo masë që përcaktohet sipas pikës (g) në nënparagrafin 1.04 A.

(b) Për aq kohë sa huaja është e pashlyer, Ministria e tij e Transportit dhe APD-ja do të:

(i) kryejnë aktivitetet e tyre gjatë fazës së investimit të Projektit në përputhje me ligjet mjedisore, të aplikueshme mbi to dhe me standardet dhe praktikat e Bashkimit Europian në fushën e mbrojtjes së mjedisit, siç mund të ndryshohen ose modifikohen dhe të sigurojë dhe të ruajë të gjithë autorizimet qeveritare që aplikohen mbi to;

(ii) kryejnë të gjitha funksionet që lidhen me Projektin përfshirë dhe mirëmbajtjen, në përputhje me ligjet, standardet dhe praktikat, të cilat përmenden në pikën (a) të këtij paragrafi;

(iii) sigurojë që në kryerjen e Projektit nuk do të përdoren materiale dhe substanca, të cilat mund të kenë një efekt negativ mbi mjedisin, sipas ligjeve, standardeve dhe praktikave, të cilat përmenden në pikën (a) të këtij paragrafi; dhe

(iv) zbatojë, vërë në funksion dhe mirëmbajë komponentët e Projektit, në përputhje me Planin e Menaxhimit të Portit të Durrësit", i cili është hartuar për Projektin e përmendur në citimin e katërt.

6.12. Revizionimi i llogarive

Për aq kohë sa huaja është e pashlyer, Huamarrësi do të sigurojë që të gjithë deklaratat e APD-së për çdo vit financiar që përfundon pas vitit 2001 do të revizionohen çdo vit, sipas standardeve përgjithësisht të pranueshme të revizionimit nga firma revizorësh me reputacion ndërkombëtar dhe të pranueshëm për Bankën.

Neni 7
Siguria

7.01. Siguria

Në qoftë se Huamarrësi do t'i akordojë një Pale të tretë sigurinë për shlyerjen e detyrimeve debitore të jashtme ose ndonjë preferencë apo prioritet lidhur me to, Huamarrësi do të informojë Bankën dhe, në qoftë se kërkohet nga Banka, do t'i sigurojë Bankës siguri të barabartë për shlyerjen e detyrimeve të tij, ose do t'i akordojë Bankës një preferencë ose prioritet të barabartë.

Huamarrësi deklaron se aktualisht nuk ekziston ndonjë siguri, preferencë apo prioritet i tillë.

Neni 8
Informacioni dhe vizitat

8.01. Informacioni lidhur me Projektin

Huamarrësi do të sigurojë që:

(a) Ministria e tij e Transportit, që vepron nëpërmjet njësisë së zbatimit të Projektit, do t'i dërgojë Bankës dokumentet e mëposhtme, të përgatitura me ndihmën e firmës së konsulentit të cilës i referohet në paragrafin 6.08, në gjuhën angleze ose të përkthyer në anglisht:

(i) brenda 90 ditësh nga data e disbursimit të çdo Transhi, që nuk është i fundit, evidencën sipas kërkesës së Bankës, dhe të vërtetuar nga PIU dhe firma e konsulentit, në kuptimin që shuma totale e atij Transhi dhe të gjithë Transheve të disbursuar më parë, nuk tejkalon më shumë se me 500 000 euro shumën totale të të gjitha shpenzimeve (tatimet dhe detyrimet neto që paguhen në Shqipëri) të realizuara nga Huamarrësi për komponente të Projektit, të cilët në përshkrimin e Projektit përmenden si kualifikues për financim nga Banka;

(ii) një raport mbi zbatimin e Projektit duke filluar nga data 31 janar 2002 dhe më pas çdo muaj;

(iii) çdo lloj dokumenti apo informacioni tjetër lidhur me financimin dhe zbatimin e Projektit, që Banka me arsye herë pas here mund t'i kërkojë;

(iv) një raport të përfundimit të Projektit, brenda gjashtë muajsh nga data e përfundimit të Projektit.

(b) Regjistrat e Ministrisë së tij të Transportit të tregojnë të gjithë veprimtarinë e tij që lidhet me financimin dhe zbatimin e Projektit.

(c) Ministria e tij e Transportit dhe APD-ja, të cilët së bashku veprojnë nëpërmjet njësisë së zbatimit të Projektit, t'i paraqesin pa vonesë Bankës për miratim çdo ndryshim të materialeve të planeve të përgjithshme, afateve, planeve financiare ose programit të shpenzimeve për Projektin, duke i lidhur me ekspozetë e bëra para Bankës përpara nënshkrimit të Kontratës.

(d) Sipas kërkesës së arsyetuar të Bankës, APD-ja të dërgojë herë pas here çdo dokument apo informacion që lidhet me veprimtarinë e Projektit.

(e) Banka do të informohet paraprakisht nga Huamarrësi dhe sipas rastit nga APD-ja për çdo lloj situate që kërkon miratimin e Bankës sipas paragrafit 6.07.

(f) Dhe Banka do të informohet përgjithësisht nga Huamarrësi dhe APD-ja për çdo fakt apo ngjarje që njihet nga Huamarrësi ose sipas rastit nga APD-ja, që mund të cenojë ose ndikojë në mënyrë të konsiderueshme mbi kushtet e zbatimit apo të funksionimit të Projektit.

8.02. Informacioni lidhur me Huamarrësin

Huamarrësi do të informojë Bankën:

(a) menjëherë, për çdo vendim që merret nga ai për çdo arsye, për çdo fakt që e detyron atë dhe për çdo kërkesë që i është bërë për të parapaguar huanë;

(b) menjëherë, për njohjen e tij, besimin prej tij ose, sipas rastit, arsyet për të besuar se ka ndodhur ose ka të ngjarë të ndodhë një ngjarje e ndryshimit të kontrollit (siç përkufizohet në nënparagafin 4.03 (C), ku një informacion i tillë do të komunikohet menjëherë sapo Huamarrësi të ketë shkaqe të arsyeshme për të patur një besim të tillë;

(c) menjëherë, për çdo lloj qëllimi nga ana e tij për të krijuar ndonjë interes sigurimi mbi ndonjërin prej aktiveve të tij në favor të një Pale të tretë për realizimin e secilit prej detyrimeve të tij të jashtme ose ndonjë preference apo prioritet që lidhet me të; dhe

(d) përgjithësisht, për çdo fakt apo ngjarje që mund të pengojë përmbushjen e ndonjë detyrimi të Huamarrësit nën këtë kontratë.

8.03. Vizitat

Huamarrësi do të lejojë dhe do të sigurojë që ADP-ja gjithashtu të lejojë personat e caktuar nga Banka, të cilët mund të shoqërohen nga përfaqësues të Gjykatës së Revizorëve, të vizitojnë kantieret, instalimet dhe punimet që përfshihen në Projekt dhe të kryejnë kontrolle sipas dëshirës. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të sigurojë për ata ose do të sigurohet që ata të kenë të gjithë asistencën e nevojshme.

Neni 9
Detyrimet dhe shpenzimet

9.01. Taksat, tatimet dhe tarifat

Huamarrësi do të paguajë të gjitha taksat, tatimet, tarifat dhe detyrime të tjera të çdo lloj natyre, duke përfshirë pullat dhe tarifat e regjistrimit, që mund të dalin të nevojshme gjatë zbatimit të kësaj Kontrate dhe çdo dokument tjetër që lidhet me të, dhe për krijimin e çdo lloj sigurimi për huanë.

Huamarrësi do ta paguajë të gjithë principalin, interesin, komisionin dhe shuma të tjera që duhen paguar nën këtë Kontratë, si bruto, pa zbritje për shkak të ndonjë detyrimi kombëtar ose vendas të çdo lloji; me kusht që, në qoftë se Huamarrësi është i detyruar sipas ligjit të bëjë ndonjë zbritje të tillë, kjo do t'i shtohet pagesës bruto të Bankës në mënyrë që pas zbritjes, shuma neto që do të merret nga Banka të jetë e barabartë me shumën që duhet paguar.

9.02. Detyrime të tjera

Huamarrësi do të marrë përsipër të shlyejë çdo kosto profesionale, bankare, të transfertave apo këmbimit që shkaktohen gjatë zbatimit të kësaj Kontrate dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me të, si dhe në krijimin e sigurisë për huanë.

Neni 10
Parapagesa në rast mospagese

10.01. E drejta për të kërkuar shlyerjen

A) Huamarrësi do të shlyejë huanë ose çdo pjesë të saj menjëherë pas kërkesës së bërë nga Banka:

(a) në qoftë se ndonjë material, informacion ose dokument që i është dhënë Bankës nga ose në emër të Huadhënies në lidhje me bisedimet për këtë Kontratë ose gjatë jetës së saj, provohet se ka qenë jokorrekt në ndonjë material të veçantë;

(b) në qoftë se Huamarrësi nuk arrin të shlyejë në datën e duhur ndonjë pjesë të Huasë, të paguajë interesin mbi të, ose t'i bëjë ndonjë pagesë tjetër Bankës siç parashikohet;

(c) në qoftë se Huamarrësi dështon në përmbushjen e ndonjë detyrimi financiar në lidhje me ndonjë hua (hua tjetër përveç huasë) që është akorduar nga Banka ose Komuniteti Europian dhe në qoftë se pas ndonjë mospagese Huamarrësit i kërkohet të parapaguajë ndonjë hua tjetër ose të shlyejë përpara afatit të maturitetit çdo debit që do të lindë nga transaksioni financiar;

(d) në qoftë se merret një vendim ose miratohet një zgjidhje për mbylljen e APD-së ose në qoftë se APD-ja pushon së ekzistuari ose ndërpret të gjithë ose një pjesë të rëndësishme të aktivitetit të tij, përveç rastit kur realizohet një shkrirje apo riorganizim që është miratuar paraprakisht nga Banka;

(e) në qoftë se APD-ja kërkon falimentimin e tij, deklaron se do të ndalojë pagesën, kërkon një moratorium mbi pagesën, është subjekt i një kërkese për falimentimin të paraqitur nga një Palë e tretë, deklarohet si i falimentuar, ose bën apo kërkon të bëjë ndonjë rregullim ose kompozim me, ose caktimin në favor të kreditorëve të tij pa u deklaruar si i falimentuar;

(f) në qoftë se pas një dështimi të Huamarrësit në realizimin e ndonjë detyrimi që lidhet me huanë nga Banka Ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim ose granteve të Huamarrësit për të tërhequr të ardhurat e asaj huaje ose ndonjë granti të tillë do të anulohet ose përfundojë tërësisht ose pjesërisht ose në qoftë se ajo hua ose ndonjë grant i tillë do të bëhet i ripagueshëm sipas kushteve të tij; ose

(g) në qoftë se ndodh ndonjë ngjarje apo situatë që ka të ngjarë të rrezikojë Huanë ose ndikojë negativisht mbi sigurinë e saj.

B) Huamarrësi do të shlyejë Huanë ose ndonjë pjesë të saj menjëherë pas kërkesës që bëhet nga Banka pas skadimit të një periudhe të arsyeshme kohore të përcaktuar në një njoftim të Bankës për Huamarrësin, pa e ndrequr çështjen sipas pëlqimit të Bankës:

(a) në qoftë se Huamarrësi nuk përmbush ndonjë detyrim tjetër nën këtë Kontratë përveç pagesës së detyrimit të cilës i referohet në pikën (b) të nënparagrafit 10.01 A;

(b) në qoftë se ndonjë fakt ose rrethanë të cilave u referohet në citimet provohet se është i/e gabuar, ndryshon ndjeshëm ose pushon së ekzistuari për shkak të cenimit të interesave të Bankës si Huadhënës i Huamarrësit ose ndikon negativisht mbi zbatimin ose funksionimin e Projektit.

10.02. Të drejtat e tjera në ligj

Paragrafi 10.01 nuk do të kufizojë ndonjë të drejtë tjetër të Bankës për të kërkuar shlyerjen e Huasë.

10.03. Dëmtimet

Në rast të një kërkese për parapagim sipas paragrafit 10.01, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës, për çdo Transh për t'u parapaguar, një shumë që përcaktohet në datën e kërkesës dhe që është më e madhe se:

(a) shuma e përllogaritur nga data e përcaktuar në kërkesën e Bankës, sipas dispozitave të nënparagrafit 4.02, siç aplikohet në shumën që duhet paguar dhe është bërë e pagueshme; dhe

(b) totali i shumave të përllogaritura mbi çdo këst që do të parapaguhet në normën vjetore 0.25% (zero pikë njëzetë e pesë për qind) nga data e kërkesës deri në datën në të cilën një këst i tillë do të ishte i shlyeshëm por për hartimin e kërkesës.

10.04. Heqja e të drejtës

Dështimet ose vonesat nga Banka të ushtrimit të ndonjë prej të drejtave të saj në nenin 10 nuk do të konsiderohet si heqje e një të drejte të tillë.

10.05. Aplikimi i shumave të marra

Shumat e marra pas kërkesës sipas nenit 10 do të aplikohen të parat në pagimin e dëmtimeve, komisionit dhe interesit në këtë renditje dhe së dyti në reduktimin e kësteve të papaguara në renditje të kundërt të maturitetit. Ato do të aplikohen ndërmjet Transheve sipas vendimit të Bankës.

Neni 11
Ligji dhe juridiksioni

11.01. Ligji

Kjo Kontratë do të qeveriset nga ligjet e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

11.02. Juridiksioni

Të gjitha konfliktet lidhur me këtë Kontratë do t'i paraqiten Gjykatës së Drejtësisë të Komunitetit Europian në Luksemburg.

Me anë të kësaj, Palët nën këtë Kontratë heqin dorë nga çdo formë imuniteti ose të drejte për të kundërshtuar juridiksionin e Gjykatës.

Një vendim i Gjykatës që jepet në zbatim të këtij paragrafi 11.02 do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për Palët, pa kufizime apo rezerva.

11.03. Evidenca e shumave për t'u paguar

Në çdo veprim ligjor që del i nevojshëm nga kjo Kontratë, certifikata e Bankës përsa i përket ndonjë shume që duhet t'i paguhet Bankës nën këtë Kontratë, do të jetë evidenca primare për një shumë të tillë.

Neni 12
Pikat përfundimtare

12.01. Njoftimet

Njoftimet dhe komunikimet e tjera që jepen sipas kësaj Kontrate do të dërgohen në adresat e përmendura më poshtë, përveç rasteve kur njoftimet për Huamarrësin kanë të bëjnë me akt-padi që nuk dërgohen poshtë ku Huamarrësi ka zgjedhur përfaqësinë.

- për Huamarrësin: (1) Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Albania

(2)Misioni i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian
Bashkimi Europian
Rue Tenbosch 30
B-1000 Brussels
- Për Bankën:100, boulevard Konrad Adenauer
L-2950 Luxembourg

Secila Palë mundet, duke njoftuar tjetrën, të ndryshojë adresën (adresat) e tyre siç shpallen më

lart, me kusht që adresa e përmendur nën pikën (2) më lart mund të ndryshohet vetëm me një adresë tjetër brenda Bashkimit Europian.

12.02. Forma e njoftimit

Njoftimet dhe komunikimet e tjera, për të cilat në këtë Kontratë janë përcaktuar periudha fikse ose të cilët i caktojnë vetë periudhat që janë të detyrueshme për marrësin do të dërgohen dorazi, nëpërmjet postës së regjistruar, telegram, teleks ose mjete të tjera transmetimi të cilat evidentojnë marrjen e tyre nga marrësi. Data e regjistrimit ose, sipas rastit, data e deklaruar e marrjes së transmetimit do të jetë përfundimtare për përcaktimin e një periudhe.

12.03. Citimet, plani dhe aneksi

Citimet dhe plani A (Përshkrimi i Projektit) janë pjesë përbërëse të kësaj Kontrate.

Bashkëngjitur kësaj është aneksi I (Autoriteti i nënshkruesit për Huamarrësin).

Në dëshmi të tyre, Palët e pranishme kanë mundësuar zbatimin e kësaj Kontrate e cila është në pesë kopje origjinale në gjuhën angleze. Secila faqe përveç kësaj faqeje e nënshkruar në emër të Bankës nga Z.A.H Brndt Corstius, këshilltar i lartë.

Tiranë, 28 dhjetor 2001 Luksemburg, 28 dhjetor 2001

PLANI A
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Porti i Durrësit – Projekti i Rehabilitimit të Infrastrukturës (SHQIPËRI)

Projekti konsiston në studime, projektim, ndërtim dhe përfundimin dhe mbikëqyrjen e komponentëve të mëposhtëm:

1. Rehabilitimi i kalatave 4 dhe 7 dhe punimet përkatëse në bregdet

Komponentët që nuk financohen nga Banka:

- rindërtim/rehabilitim i kalatave 4-7;
- blerja e dy vinçave 10 ton të montuar mbi shina;
- blerja e dy stivues kontenierësh dhe dy pirunave ngritës me kapacitet 25 ton, plus pajisje për sheshin e kontenierëve.

Komponentët që në parim kualifikohen për financim nga Banka (kostot të përllogaritura nga ajo në 10.4 milion euro):

- pastrimi i pajisjeve dhe godinave të braktisura, nivelim, shtrim, drenazhim dhe shërbime (rrjetet inxhinierike dhe ndriçimi) në një sipërfaqe 120.000 m2 prapa kalatave 4-7 dhe rruga hyrëse në kalatën perëndimore;
- mundësisht projektim dhe/ose mbikëqyrje.

2. Vinça të lëvizshëm

Komponentët që në parim kualifikohen për financim nga Banka (kostot e përllogaritura nga ajo në 3.3 milion euro):

- blerja e një (ndoshta dy) vinçave të lëvizshëm me kapacitet 40.45 ton, për t'u përdorur në kalatat 6 dhe 7;
- mundësisht, projektim dhe/ose mbikëqyrje.

3. Rindërtimi i dallgëthyesit perëndimor

Komponentët që nuk financohen nga Banka:

- ndërtimi i murit mbrojtës nga dallgët në 500 metra gjatësi në pjesën e prapme të dallgëthyesit perëndimor;
- ndërtimi i murit mbrojtës nga era në 500 metra gjatësi në pjesën e prapme të dallgëthyesit perëndimor;
- Riparimi i farit të dallgëthyesit.

Komponentët që në parim kualifikohen për financim nga Banka (kostot e përllogaritura nga ajo në 3.3 milion euro):

- rehabilitimi i skarpatës mbrojtëse në dallgëthyesin perëndimor (afërsisht 1 km gjatësi).

Punimet e Projektit parashikohet të nisin nga mesi i vitit 2002.

Parashikohet që rindërtimi i dallgëthyesit perëndimor do të përfundojë nga data 31 mars 2003 dhe Projekti parashikohet të vihet në funksion në daljen 30 qershor 2004.

V E N D I M
Nr. 532, datë 31.10.2002

PËR MËNYRAT E USHTRIMIT TË FUNKSIONEVE NGA SEKSIONET E ADMINISTRIMIT DHE TË MBROJTJES SË TOKËS NË QARK DHE ZYRAT E MENAXHIMIT DHE TË MBROJTJES SË TOKËS NË KOMUNË DHE /OSE BASHKI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, 12 e 13 të ligjit nr. 8752, datë 26. 3. 2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në zbatim të këtij vendimi, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) "Resurs" nënkupton të gjitha përkufizimet e përdorura në nenin 11 të ligjit nr. 8752, datë 26. 3. 2001.

b) "Ndryshim" nënkupton ndryshimin e kategorizimit të resurseve të përcaktuara në pikën 10 të këtij vendimi.

c) "Kategori toke" nënkupton vlerësimin e tokës bujqësore sipas bonitetit.

ç) "Përdorues shtetëror" nënkupton institucionet shtetërore që kanë tokë në përdorim.

I. FUNKSIONET DHE DETYRAT E SEKSIONIT TË ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS.

1. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark ka për detyrë përcaktimin, dokumentimin dhe publikimin e të dhënave, në formën e hartave e regjistrave, dhe kryerjen e procedurave për ndryshimet, përdorimin, vlerësimin dhe mbrojtjen e resurseve në juridiksion të qarkut.

2. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark krijon bazën e të dhënave dhe sistemin e të dhënave të kadastrës për njësitë e qeverisjes vendore.

3. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark për resurset në juridiksion të qarkut, komunës dhe/ose bashkisë, mban regjistra dhe harta kadastrale për:

a) kategorizimin e resurseve;

b) pronësinë e tyre;

c) përdorimin e tyre;

ç) vendndodhjen (pozicionin, kufijtë, koordinatat, madhësinë, pjerrësinë etj);

d) treguesit, fizikë e kimikë;

dh) vlerën;

e) zonat e dëmtuara ose të rrezikuara nga dëmtimet fizike, erozioni, shkretëtirëzimi, degradimi e ndotja.

4. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark krijon dokumentacionin nga shfrytëzimi i hartave dhe i regjistrave ekzistuese, këmbimi i dokumentacionit falas me zyrat e regjistrimit, drejtoritë e shërbimit pyjor, drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit, seksionet e urbanistikës dhe institucionet e tjera, shtetërore dhe private, që zotërojnë të dhëna nga matjet e thjeshta, inventarizimet, rivelimet tipografike, fotografitë ajrore, imazhet satelitore etj.

5. Mënyra e mbajtjes së të dhënave në regjistra përgatitet nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit. Regjistrat të jenë të njësuar për të gjitha seksionet e administrimit të tokës në qarqe dhe të detyrueshme për t'u plotësuar.

6. Për pasqyrimin e treguesve të të dhënave, njësia bazë të jetë ngastra, pronë private dhe publike.

7. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark, në bashkëpunim me institucionet, private dhe shtetërore, përgatit, përditëson dhe ruan të dhënat gjeografike, në formën e hartave, për

çdo komunë dhe/ose bashki, në juridiksion të qarkut.

8. Hartat e administrimit të tokës të jenë të shkallës 1-1000, 1-2500, 1-5000, 1-10 000 dhe 1-25000.

9. Kategorizimi i resurseve të jetë: tokë bujqësore, tokë urbane e fshatit (truall), tokë pyjore, pyll, kullotë, livadh, breg lumi, tokë e pafrytshme.

10. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki pasqyrojnë të dhënat për treguesit fizikë, kimikë dhe të bonitetit të tokave bujqësore.

11. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark shërben si bazë lidhjeje për sistemet informatike të specializuara për nevojat që kanë institucionet e ndryshme dhe njësitë e qeverisjes vendore, kur ato përdorin të dhënat kadastrale.

12. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark kryen shërbime dypalëshe, informacione me zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për ndryshimet e pronësisë dhe bashkimet e parcelave, si rezultat i efektit të tregut të tokës ndryshimet pasqyrohen çdo 6 muaj.

13. Seksioni i administrimit dhe mbrojtes së tokës në qark u jep të dhëna kadastrale edhe për elemente të tjerë të administrimit, personave, fizikë e juridikë, privatë, kundrejt tarifave të miratuara nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

14. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark kryen procedurat për ndryshimet e kategorive të tokës, në bazë të aktit të organit përkatës, sipas dispozitave në fuqi, dhe bën pasqyrimet përkatëse në regjistrat dhe në hartat.

15. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark kryen procedurat për zbatimin e vendimeve të organeve shtetërore përgjegjëse për kalimet dhe ndryshimet në gjendjen e tokave dhe bën pasqyrimet përkatëse.

16. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark ndjek përditësimet periodike të fondit të tokës dhe kryen veprimet përkatëse në dokumentacion. Në bashkëpunim me institucionet e specializuara, shtetërore ose private, organizon punën për kryerjen e rilevimeve topografike.

17. Seksioni i administrimit dhe mbrojtes së tokës në qark, në bazë të dokumentacionit që merr nga zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki pasqyron çdo 6 muaj të dhënat e fondit të tokës bujqësore, të tokave pyjore e pyjeve, kullotave, livadheve, trojeve, brigjeve të lumenjve dhe tokave të pafrytshme; dhe përmbledhëset e fondit, në shkallë qarku, paraqiten në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit bën përmbledhësen në shkallë republike.

18. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark, në bashkëpunim me institucionet e specializuara, kryen studime për përdorimin e tokës sipas metodikave të miratuara nga organet përgjegjëse dhe ndjek zbatimin e tyre.

19. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki pasqyrojnë, çdo vit, ndryshimet në përdorimin e tokës dhe bëjnë përmbledhëset në shkallë komune dhe qarku. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit bën përmbledhësen në shkallë republike.

20. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki, pasqyrojnë, çdo vit, ndryshimet e treguesve, fizikë e kimikë, të tokës si rezultat i kryerjes së analizave nga zotëruesit, privatë dhe shtetërorë, në laboratorë të certifikuar dhe në bashkëpunim me institucionet e specializuara, në përputhje me metodikat e miratuara nga Instituti i Studimit të Tokave, dhe bëjnë ndryshimet në kategorizimin e tokave sipas bonitetit.

21. Në rastet e dëmtimit të cilësive të tokave, si rezultat i veprimit të faktorëve natyrorë, ndryshimi i kategorisë së tokave sipas bonitetit bëhet me miratim të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit. Ndryshimi bëhet me propozimin e seksionit të administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe në bazë të aktvlerësimit zyrtar të Institutit të Studimit të Tokave.

22. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe zyra e menaxhimit dhe mbrojtjtes së tokës në komunë dhe/ose bashki, në bashkëpunim me institucionet e specializuara kryejnë procedurat për vlerësimin e tokave, për përcaktimin e vlerës, të shpronësimit e taksimit, në bazë të metodikave të miratuara për këtë qëllim nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

23. Seksioni i administrimit dhe i mbrojtjes së tokës në qark, në bashkëpunim me zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki, ndjekin dhe mbështesin zbatimin e

politikave a të projekteve të miratuara nga organet përkatëse për forcimin e fermave private.

24. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark, në bashkëpunim me zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki, përcaktojnë dëmtimet e tokës bujqësore nga ndërtimet pa leje. Për shkeljet marrin masa administrative, të përcaktuara sipas ligjit nr. 7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative" dhe njoftojnë organet drejtuese të komunës dhe/ose të bashkisë e qarkut.

25. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark bashkërendon punën me zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki dhe me institucionet e specializuara shtetërore për përcaktimin e zonave të dëmtuara ose të rrezikuara nga dëmtimet, si rezultat i erozionit, shkretëtirëzimit, degradimit e ndotjeve.

26. Seksioni i administrimit dhe i mbrojtjes së tokës në qark kontrollon zbatimin e projekteve për shfrytëzimin e resurseve nga shoqëritë private. Në raste shkeljesh, merr masa administrative, të përcaktuara në ligjin nr. 7697, datë 7.4.1993 dhe njofton organet drejtuese të komunës dhe/ose bashkisë, qarkut dhe institucionin shtetëror, i cili ka lëshuar licencën e shfrytëzimit.

27. Seksioni i administrimit dhe i mbrojtjes së tokës në qark bashkëpunon me zyrën e planifikimit të territorit të qarkut për kryerjen e studimeve, për krijimin dhe zgjerimin e sipërfaqeve urbane në zonat rurale.

II. FUNKSIONET DHE DETYRAT E ZYRËS SË MENAXHIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS

1. Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki ka për detyrë grumbullimin e të dhënave dhe kryen procedurat për shfrytëzimin e resurseve, që me ligj i kalojnë komunës dhe/ose bashkisë.

2. Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki kryen studime për përdorimin e resurseve, që me ligj i kalojnë komunës dhe/ose bashkisë. Studimet miratohen nga këshilli i komunës dhe/ose i bashkisë.

3. Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki ndjek procedurat për dhënien me qira të tokës bujqësore, pyjeve, kullotave, livadheve, tokave pyjore e brigjeve të lumenjve, që me ligj i kalojnë në përdorim komunës dhe/ose bashkisë.

4. Zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki ndjek zbatimin e projekteve për përdorimin dhe mbrojtjen e tokës, të hartuara nga komuna, qarku ose institucionet shtetërore.

5. Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki është përgjegjëse përpara organeve drejtuese të komunës dhe/ose të bashkisë për shfrytëzimin e resurseve.

6. Seksionet e administrimit dhe mbrojtjtes së tokës në qark bashkëpunojnë me zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki dhe me institucionet e specializuara për hartimin e studimeve për përdorimin e tokës.

7. Seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës, në studimet për përdorimin e tokës, përcaktojnë termat e referencës, mundësitë për ndryshime, vlerësojnë përshtatshmërinë e tokës dhe mundësitë mjedisore, ekonomike e shoqërore.

8. Studimet për përdorimin e tokës, të hartuara nga institucionet e specializuara, nga seksionet e administrimit dhe mbrojtjtes së tokës në qark dhe nga zyra e menaxhimit dhe e mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki diskutohen për një periudhë 2-mujore në bashkinë e njësive vendore, për të cilat është kryer studimi.

9. Studimet e kryera nga seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe zyra e menaxhimit të mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki, përpara miratimit, vlerësohen të paktën nga dy institucione të specializuara, të përcaktuara nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

10. Studimet për përdorimin e tokës, përpara zbatimit, miratohen në këshillin e qarkut.

III. PROCEDURAT PËR NDRYSHIMIN E KATEGORIZIMIT TË RESURSEVE

1. Ndryshimi i kategorisë së tokave pyjore, kullotave, livadheve dhe pyjeve në tokë bujqësore, për efekt të zbatimit të normave ligjore përkatëse, në përputhje me udhëzimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, me propozimin e këshillit të komunës dhe/ose bashkisë dhe këshillit të qarkut, miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

2. Ndryshimi i kategorisë së tokave pyjore, kullotave, livadheve e pyjeve shtetërore në toka bujqësore, me propozimin e këshillit të komunës dhe/ose bashkisë dhe këshillit të qarkut, miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

3. Ndryshimi i kategorisë së tokave bujqësore, pyjore, kullotave, livadheve e pyjeve në tokë truall bëhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998, "Për urbanistikën".

4. Ndryshimi i kategorisë nga tokë e pafrytshme më tokë bujqësore, tokë pyjore, pyll, livadh dhe kullotë bëhet me propozimin e këshillit të komunës, dhe/ose bashkisë dhe të këshillit të qarkut dhe miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

5. Ndryshimi i kategorisë nga tokë bujqësore në tokë të pafrytshme, në livadh, kullotë, tokë pyjore dhe pyll bëhet me propozimin e këshillit të komunës dhe/ose bashkisë dhe të qarkut dhe miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

6. Ndryshimet sipas pikave 1,2,3 dhe 4, të sipërpërmendura bëhen sipas raportit teknik të hartuar nga zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki, nga seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark, në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe me Institutin e Studimit të Tokave. Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit harton udhëzim të veçantë për ndryshimet, sipas pikave të sipërpërmendura.

IV. PËR MBROJTJEN DHE RIAFTËSIMIN E TOKAVE

1. Institucionet shtetërore, që japin licenca shfrytëzimi për resurset, për qëllime jobujqësore, të cilat, me ligj, janë vënë në përdorim të qarkut, të komunës dhe/ose bashkisë, janë të detyruara të marrin mendimin e këshillit të qarkut, të këshillit të komunës dhe/ose bashkisë dhe miratimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

2. Institucionet shtetërore, që japin licenca shfrytëzimi, për qëllime jobujqësore, për tokat bujqësore shtetëtore, janë të detyruara të marrin miratimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

3. Kur personi fizik ose juridik, lidh marrëveshje me pronarë privatë toke, institucioni shtetëror, që jep licencë shfrytëzimi, është i detyruar të marrë miratimin e këshillit të komunës dhe/ose bashkisë.

4. Në të gjitha rastet, investitori që shfrytëzon resurset për qëllime jobujqësore është i detyruar t'i kthejë ato në gjendjen e mëparshme, jo më vonë se 6 muaj nga përfundimi i shfrytëzimit.

5. Riaftësimi i resurseve bëhet nga investitori, sipas projekteve të riaftësimit. Projektet e riaftësimit, përpara zbatimit, vlerësohen nga Instituti i Studimit të Tokave dhe miratohen nga institucioni që ka në pronësi ose në përdorim resursin.

6. Vendimi nr. 256, datë 2.8.1991 i Këshillit të Ministrave "Për rregulloren, për regjistrimin, ndryshimin dhe kalimin në gjendjen e tokave dhe detyrat e kadastrës" dhe çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 535, datë 31.10.2002

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË AGJENCISË SË NXITJES SË INVESTIMEVE TË HUAJA (ANIH) PËR VITIN 2002

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 8 të ligjit nr. 8877, datë 4.4.2002 "Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja, për periudhën e mbetur të vitit 2002, t'i jepet fondi prej 6 500 000 (gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekësh për përballimin e shpenzimeve operative të kësaj agjencie, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ANEKS

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E BUXHETIT TË AGJENCISË SË NXITJES SË INVESTIMEVE TË HUAJA

(000 lek)

	Zërat e shpenzimeve		SHUMA
	Shpenzime për paga e shpërblime		2500
	Pagat e punonjësve	17*53*2 muaj)	1810
	Pagesa e sigurimeve shoqërore	(34%*1802)	600
	Fondi i veçantë	(5%*1802)	90
	Shpenzime operative		1500
	Shpenzime marketingu/promocioni		
	Shpërblimi i Këshillit mbikëqyrës		627
	Kryetari	(30%*110*3 mbledhje	66
	Anëtarët	(20%*110*3 mbledhje*10 persona)	350
	Tel/fax	(100.*2 muaj)	100
	Internet	(14*2muaj)	28
	Energji elektrike	(28*2 muaj)	56
	Karburant	(42*2muaj)	50
	Kancelari	(40* 2 muaj)	40
	Shpenzime postare	(7*2 muaj)	14
	Roje objekti	(20*3*1,3*2 muaj)	156
	Mirëmbajtje ambienti	(15*2 muaj)	30
	Shpenzime për udhëtime e dieta (brenda e jashtë shtetit)		400
	Shpenzime për riparim automjeti	(13* 2 muaj)	0
	Shpenzime për pritje, përcjellje	(30* 2 muaj)	60
	Shpenzime për investime		2500
	Rezervë		0
	Totali		6500

V E N D I M
Nr. 537, datë 24.10.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURISË SË PALUAJTSHME, QË PREKET NGA NDËRTIMI I SUPERSTRADËS VORË-DURRËS, SEKSIONI I DYTË SUKTH-DURRËS (KRYQËZIMI I URËS SË DAJLANIT)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i superstradës Vorë-Durrës, seksioni i dytë Sukth-Durrës (Kryqëzimi i Urës së Dajlanit).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të cilët shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe 1199 m2 tokë truall e një objekt me sipërfaqe 144 m2, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 10 800 740 (dhjetë milionë e tetëqind mijë e shtatëqind e dyzet) lekësh.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 115 500 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekësh.

5. Fondi prej 10 916 240 (dhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar dhe shpenzimet procedurale, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2002, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.10.2002.

7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

QARKU: DURRES
BASHKIA: DURRES

LISTA E PERSONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR SHKAK TË NDËRTIMIT TË KRYQËZIMIT TË URËS SË DAJLANIT, PJESË E SUPERSTRADES SUKTH – DURRËS.

Lloji i pasurise se paluajtshme: truall dhe ndërtesë nr.1-9.

	PRONAR			TRUALL			NDËRTESE				
Nr	Emer	Mbiemer	Nr.Pasurise	Sip/m2	leke/m2	Vlera leke	Sip/m2	leke/m2	Vlera leke	Totali leke	Shenime
1	Dashamir	Luga	7 49	106	5500	583000				583000	
2	Pranvera	Luga(Kalaci)	7 49	106	5500	583000				583000	
3	Sanije	Luga(Hyskja)	7 49	106	5500	583000				583000	
4	Liri	Luga(Fani)	7 49	106	5500	583000				583000	
5	Gezim	Luga(Fani)	7 49	106	5500	583000				583000	
6	Hysen	Luga	7 49	106	5500	583000				583000	
7	Kol	Hudhra		563	5500	3096500				3096500	Proces regjistrimi
8	Myfit	Myrtaj	5 43				72	29210	2103120	2103120	
9	Hanushe	Myrtaj	5 43				72	29210	2103120	2103120	
	SHUMA			1199			144			10800740	

Shpenzime procedurale që përfshijnë botimin 115 500 lek.

Vlera totale e shpronësimit 10 916 240 lek.

V E N D I M
Nr. 538, datë 24.10.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURISË SË PALUAJTSHME, QË PREKET NGA NDËRTIMI I SUPERSTRADËS VORË-DURRËS, SEKSIONI I PARË VORË-SUKTH (INTER-CHANGE SUKTH)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.

8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i superstradës Vorë-Durrës, seksioni i parë Vorë-Sukth (Inter-Change Sukth).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe 20 821 m2 tokë arë, 5192 m2 tokë truall, një objekt me sipërfaqe 96 m2 dhe 144 708 lekë kultura bujqësore, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 44 072 708 (dyzet e katër milionë e shtatëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetë) lekësh.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 595 000 (pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekësh.

5. Fondi prej 44 667 708 (dyzet e katër milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetë) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar dhe të shpenzimeve procedurale, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2002, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.11.2002.

7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikcionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

QARKU: DURRËS
KOMUNA: XHAFZOTAJ

Fshati: Koxhas, Borake, Sukth i Ri dhe Bashkia Sukth

Lista e pronarëve që shpronësohen për shkak të ndërtimit të superstradës Vorë - Durrës, seksioni i parë Vorë – Sukth

Zona Kadastrale 2255, 1242,3541 Lloji i pasurisë së paluajtshme : Truall, objekt,toke are dhe kult.bujq.

		Pronar		Nr.		Truall/objekt		Toke are			Vlera k.b.	Totali	Shenime
Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	Pasuris.	Sip.m2	lek/m2	Vlera	Sip.m2	lek/m2	Vlera	ne leke	ne leke	
1	Myftar	Qamil	Guza	22/19				810	1600	1296000	5630	1301630	
2	Myftar	Qamil	Guza	24/3				176	1600	281600	1223	282823	
3	Mahmudije		Tanushi	37/4				82	1600	131200	570	131770	
4	Flutura		Tanushi	"				82	1600	131200	570	131770	
5	Besnike		Tanushi	"				82	1600	131200	570	131770	
6	Shqiponja		Tanushi	"				82	1600	131200	570	131770	
7	Genc		Tanushi	"				82	1600	131200	570	131770	
8	Halil		Tanushi	"				82	1600	131200	570	131770	
9	Osman	Omer	Tukuri	37/3				60	1600	96000	417	96417	Proc. rregjis
10	Murat	Hysen	Guzina	159				70	1600	112000	486	112486	Proc. rregjis
11	Fadil	Ahmet	Guzina	156				1440	1600	2304000	10008	2314008	Proc. rregjis
12	Sali	Shyqyri	Kotrolli	156				1216	1600	1945600	8451	1954051	Proc. rregjis
13	Ramazan	Sali	Guzina	153				1606	1600	2569600	11162	2580762	Proc. rregjis
14	Ndricim	Sali	Deliallisi	153				392	1600	627200	2724	629924	Proc.

													rregjis
15	Ahmet		Guzina	110-111				141	1600	225600	980	226580	Proc. rregjis
16	Lumturi	Adem	Guzina	110-111				65	1600	104000	452	104452	Proc. rregjis
17	Hamdi	Ali	Hoxha	110-111				10	1600	16000	70	16070	Proc. rregjis
18	Mehmet		Sabli	110-111				40	1600	64000	278	64278	Proc. rregjis
19	Vjollca	Haxhi	Velja	146				2730	1600	4368000	18974	4386974	Proc. rregjis
20	Zamir	Islam	Sinjari	149				2185	1600	3496000	15186	3511186	Proc. rregjis
21	Xhaferr	Sadik	Daci	149				465	1600	744000	3232	747232	Proc. rregjis
22	Jashar	Halil	Prejsi	149				267	1600	427200	1856	429056	Proc. rregjis
23	Pulie	Pal	Prejsi	149				250	1600	400000	1738	401738	Proc. rregjis
24	Xhemal	Zenel	Dervishi	149				405	1600	648000	2815	650815	Proc. rregjis
25	Nexhmedin	Sabri	Pupulaku	149				550	1600	880000	3822	883822	Proc. rregjis
26	Faik	Hysen	Hyseni	149				492	1600	787200	3419	790619	Proc. rregjis
27	Idriz	Seit	Losha	149				197	1600	315200	1369	316569	Proc. rregjis
28	Seit	Ahmet	Losha	149				197	1600	315200	1369	316569	Proc. rregjis
29	Faik	Seit	Losha	149				197	1600	315200	1369	316569	Proc. rregjis
30	Hysen	Hysen	Hyseni	149				182	1600	291200	1265	292465	Proc. rregjis
31	Agim	Hysen	Hyseni	149				182	1600	291200	1265	292465	Proc. rregjis
32	Ramazan	Qerim	Kadriu	148				110	1600	176000	764	176764	Proc. rregjis
33	Xhevit	Qerim	Kadriu	148				110	1600	176000	764	176764	Proc. rregjis
34	Nue	Gjon	Rama	148				336	1600	537600	2335	539935	Proc. rregjis
35	Mustafa	Bajram	Shera	148				345	1600	552000	2398	554398	Proc. rregjis
36	Abaz	Abaz	Vrioni	148				333	1600	532800	2314	535114	Proc. rregjis
37	Kujtim	Ferhat	Hysenaj	148				136	1600	217600	945	218545	Proc. rregjis
38	Yzeir	Ferhat	Hysenaj	148				136	1600	217600	945	218545	Proc. rregjis
39	Ramiz	Ferhat	Hysenaj	148				136	1600	217600	945	218545	Proc. rregjis
40	Qani	Qerim	Haxhijahja	148				221	1600	353600	1536	355136	Proc. rregjis
41	Shyqyri	Arshi	Toska	148				221	1600	353600	1536	355136	Proc. rregjis
42	Hasan	Ali	Sabli	148				624	1600	998400	4337	1002737	Proc. rregjis
43	Muharrem	Hasan	Sabli	189				441	1600	705600	3065	708665	Proc. rregjis
44	Agim	Ibrahim	Hidri	189				195	1600	312000	1355	313355	Proc. rregjis
45	Ramadan	Ethem	Banushi	189				97	1600	155200	674	155874	Proc. rregjis
46	Hajri	Hysen	Haxhiu	189				10	1600	16000	70	16070	Proc. rregjis

47	Riza	Xhevit	Varoshi	180				561	1600	897600	3899	901499	Proc. rregjis
48	Osman	Xhelal	Arifi	193				19	1600	30400	132	30532	Proc. rregjis
49	Ahmet	Liman	Ramanliu	193				19	1600	30400	132	30532	Proc. rregjis
50	Ferik	Osman	Luku	193				25	1600	40000	174	40174	Proc. rregjis
51	Zenepe	Vesel	Jaholli	193				25	1600	40000	174	40174	Proc. rregjis
52	Lindita	Safet	Llaca	193				25	1600	40000	174	40174	Proc. rregjis
53	Luan	Safet	Llaca	193				25	1600	40000	174	40174	Proc. rregjis
54	Zeqir	Hasan	Mehmeti	193				29	1600	46400	202	46602	Proc. rregjis
55	Sabrije	Hamdi	Keci	193				20	1600	32000	139	32139	Proc. rregjis
56	Luan	Ramazan	Cara	193				36	1600	57600	250	57850	Proc. rregjis
57	Riza	Qazim	Jasini	193				109	1600	174400	758	175158	Proc. rregjis
58	Kasem	Isuf	Cami	194				612	1600	979200	4253	983453	Proc. rregjis
59	Rexhep	Elmaz	Rexhepi					210	1600	336000	1460	337460	Proc. rregjis
60	Ideal	Teki	Jaholli	194				208	1600	332800	1446	334246	Proc. rregjis
61	Leo		Kore	194				30	1600	48000	208	48208	Proc. rregjis
62	Ramazan	Qerim	Omeri	194				162	1600	259200	1126	260326	Proc. rregjis
63	Shuaip	Qerim	Omeri	194				238	1600	380800	1654	382454	Proc. rregjis
64	Servet	Naim	Pelivani	180				200	1600	320000	1390	321390	Proc. rregjis
65	Nuredin	Ahmet	Mica		140	2000	280000					280000	Proc. rregjis
66	Dajti		Jaholli		120	2000	240000					240000	Proc. rregjis
67	Trashigimtaret e Ahmet Sabli				1282	2000	2564000					2564000	Proc.rregjs
68	Trashigimtaret e Halil Sabli				1600	2000	3200000					3200000	Proc.rregjs
69	Trashigimtaet ret e Selim Sabli				2050	2000	4100000					4100000	Proc.rregjs
70	Hasan		Sabli		96	2400	230400					230400	
	Totali				5192/96		10614400	20821	102400	33313600	144708	44072708	

Mbyllet me numrin rendor 70.
Shpenzime proceduriale për publikimet 595 000 lek
Vlera totale për shpronësim 44 667 708 lek.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:
- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar);



U dorëzua për shtyp më 14. 11. 2002
Doli nga shtypi më 15. 11. 2002

Tirazhi: 4250 copë Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë